



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.03.2022)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan (relatore znj. Marçela Shehu) *(seancë e shtyrë nga mbledhja e datë 15 shkurt).*

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:42 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** *(kryetare)*
- 2. Fatmira Luli*** *(anëtare)*
- 3. Irena Plaku*** *(anëtare)*
- 4. Dritan Hallunaj*** *(anëtar)*
- 5. Ridvan Hado*** *(anëtar)*
- 6. Alban Toro*** *(anëtar)*
- 7. Brikena Ukperaj*** *(anëtare)*
- 8. Marçela Shehu*** *(anëtare)*
- 9. Yllka Rupa*** *(anëtare)*

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. ***Ilir Rusi.***

Shënim: Nuk mori pjesë në shqyrtimin e kësaj çështjeje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe marrëdhënieve me jashtë.**
- 3. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Lorena Gerveni, Drejtore e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
- 5. {...}, Inspektor magjistrat i komanduar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.**
- 6. Mimoza Koçiu, Këshilltare për median pranë Kabinetit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.**
- 7. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 8. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 9. Rezarta Taushani, Këshilltare pranë Njesisë Mbështetëse të Komisioneve.**
- 10. Rudina Palloj, Këshilltare pranë Njesisë Mbështetëse të Komisioneve.**
- 11. Staf administrativ i KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

1. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan (relatore znj. Marçela Shehu) (*seancë e shtyrë nga mbledhja e datë 15 shkurt*).

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen e radhës së Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 9 mars 2022.

Siç jeni në dijeni, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor sot do të merren në shqyrtim 13 akte. Një nga çështjet për të cilat po fillojmë është zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e

procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, shtyrë kjo nga seanca e datës 15.02.2022.

Prezent kemi përfaqësuesen nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, znj. {...}.

Dëshiroj t'ju informoj që sot nga ana e magjistratit Taulant Tafa është protokolluar në Këshillin e Lartë Gjyqësor me nr. {...} prot., datë 09.03.2022 kërkesa e magjistratit për shtyrje sërish të seancës dëgjimore, me argumentin që e ka të pamundur të jetë prezent në këtë seancë për shkaqe shëndetësore dhe bashkëlidhur ka sjellë edhe dy raporte për paaftësi të përkohshme në punë.

Merr fjalën zonja {...}:

{...}: Pasi u njoha në lidhje me këtë kërkesë të dytë të bërë nga subjekti disiplinor, vlerësoj se shkaqet për mungesën e tij janë të justifikuar, pasi lidhen me gjendjen shëndetësore. Mendoj të merret në konsideratë nga ana juaj dhe seanca e ardhshme të caktohet në vlerësimin tuaj për ditën dhe për orën.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Ç'mendim keni, relatori dhe kolegët?

Marçela Shehu: Edhe unë mendoj që shkakun dhe kërkesa e paraqitur nga gjyqtari përbën një shkak të ligjshëm për shtyrjen e seancës së sotshme dëgjimore. Kërkesa është e shoqëruar edhe me dokumentin përkatës justifikues (raportin mjekësor). Duke pasur në konsideratë axhendën e punëve gjatë këtyre ditëve, do të propozoja datën 29 mars, ora 11.00, nëse edhe kolegët do të ishin dakord.

Naureda Llagami: Shumë faleminderit!

Jemi dakord me propozimin e relatores?

Ridvan Hado: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi të shtyjë seancën dëgjimore të magjistratit {...} më datë 29 mars, ora 11:00.

Faleminderit zonja {...} për prezencën tuaj.

Punë të mbarë!

Lindita Ziguri: Faleminderit edhe juve!

**Largohen nga platforma “online” përfaqësuesit nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.03.2022)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në listën e gjyqtarëve udhëheqës të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 315, datë 22.07.2021, të ndryshuar me vendimin nr. 521, datë 03.11.2021”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.¹

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:45 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|-------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar)* |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |

¹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e treta sipas rendit të ditës.

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Ilir Rusi**.

Shënim: Zoti Kurushi futet “online” gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të shërbimeve juridike dhe marrëdhënieve me jashtë.**
- 3. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Lorena Gerveni, Drejtore e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
- 5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 7. Rezarta Taushani, Këshilltare pranë Njësisë Mbështetëse të Komisioneve.**
- 8. Rudina Palloj, Këshilltare pranë Njësisë Mbështetëse të Komisioneve.**
- 9. Staf administrativ i KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në listën e gjyqtarëve udhëheqës të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 315, datë 22.07.2021, të ndryshuar me vendimin nr. 521, datë 03.11.2021”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Naureda Llagami: Fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit “Për një ndryshim në listën e gjyqtarëve udhëheqës të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 315, datë 22.07.2021, i ndryshuar me vendimin nr. 521, datë 03.11.2021”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Për më shumë detaje fjalën ia jap zonjës Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit, zonja Kryetare!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 33 të ligjit për statusin, përcakton gjykatat e shkallës së parë pranë të cilave kandidatët për gjyqtarë, në vitin e tretë të

Shkollës së Magjistraturës, do të kryejnë praktikën profesionale. Në zbatim të këtij detyrimi ligjor, Këshilli, me vendimin nr. 316, datë 22.07.2021 ka proceduar me caktimin e trupës së gjyqtarëve udhëheqës, për një periudhë 3-vjeçare, përkatësisht për vitet 2021-2024. Ndërkohë me vendimin e po të njëjtës datë, Këshilli ka caktuar gjykatat dhe gjyqtarët udhëheqës gjatë praktikës profesionale për kandidatët për magistratë, për vitin akademik 2021-2022, sipas listës bashkëlidhur vendimit, për katërmujorin e parë (korrik-tetor 2021), të dytë (nëntor 2021-shkurt 2022) dhe të tretë (mars 2022-qershor 2022). Këshilli ka ndryshuar pjesërisht një herë listën e gjyqtarëve udhëheqës, duke zëvendësuar me vendimin nr. 521, datë 03.11.2021 magistratin udhëheqës {...} me gjyqtarin {...}.

Një nga gjyqtarët udhëheqës të caktuar për kandidatët për magistratë gjatë këtij vitit akademik është gjyqtarja {...} e cila ka ushtruar funksionin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, përkatësisht në dhomën civile të kësaj gjykate. Aktualisht kjo gjyqtare nuk e ushtron funksionin për shkak të pezullimit nga detyra për efekt të vendimit të dhënë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

Referuar parashikimeve të nenit 33, të ligjit për statusin, është Këshilli i Lartë Gjyqësor që jo vetëm përcakton trupën e magistratëve udhëheqës për kryerjen e praktikës profesionale për kandidatët për magistratë, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara në ligj, por edhe përditëson trupën e miratuar, në rastet kur magistratët e miratuar, gjenden në pamundësi për të përmbushur këtë funksion. Në rastin konkret, në kushtet kur gjyqtarja {...} nuk ushtron funksionin e gjyqtares, për shkak të pezullimit nga detyra si pasojë e shkarkimit nga organet e rivlerësimit kalimtar, është e nevojshme të bëhet zëvendësimi i saj me një gjyqtar tjetër, i cili duhet të jetë edhe ai pjesë e listës së miratuar me vendimin nr. 315, datë 22.07.2021 dhe që ushtron funksionin në dhomën civile të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Referuar listës së miratuar si dhe seksionit ku bëjnë pjesë gjyqtarët të cilët nuk janë të angazhuar aktualisht si magistratë udhëheqës për vitin akademik 2021-2022, rezulton se gjyqtarja {...} (i) është pjesë e trupës së magistratëve udhëheqës të miratuar nga Këshilli, (ii) ushtron funksionin në dhomën civile pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe (iii) nuk rezulton të jetë caktuar gjyqtar udhëheqës për vitin akademik 2021-2022.

Në këto kushte, bazuar në kërkesën e kandidatit për gjyqtar z. {...}, i cili ishte caktuar për të kryer mentorimin për katërmujorin e tretë të vitit akademik 2021-2022 pranë gjyqtares {...}, nga ana e Komisionit është përgatitur edhe projektvendimi, në pikën

e parë të të cilit është parashikuar ndryshimi pjesërisht i listës së gjyqtarëve udhëheqës, të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 315, datë 22.07.2021, të ndryshuar me vendimin nr. 521, datë 03.11.2021, gjatë praktikës profesionale të kandidatëve për magistratë të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2021-2022, duke zëvendësuar gjyqtarin udhëheqës znj. {...}, për periudhën katërmujore mars – qershor 2022, me magistratin gjyqtar udhëheqës, znj. {...}.

Në pikën 2 të projektvendimit është parashikua njoftimi i këtij vendimi Shkollës së Magjistraturës, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe gjyqtarëve {...} dhe {...}.

Së fundmi, parashikohet momenti i hyrjes në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, sipas parashikimeve të nenit 98, pika 3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Faleminderit!

Bashkëlidhur është edhe praktika mbi të cilin Komisioni ka arritur në projekt-aktin e propozuar sot për miratim nga mbledhja plenare.

Naureda Llagami: Faleminderit, Brikena!

Nëse nuk kemi diskutim mbi projekt-aktin, kalojmë në votimin e tij?

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Ndryshimin pjesërisht të listës së gjyqtarëve udhëheqës, të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 315, datë 22.07.2021, të ndryshuar me vendimin nr. 521, datë 03.11.2021, gjatë praktikës profesionale të kandidatëve për magistratë të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2021-2022, duke zëvendësuar

gjqtarin udhëheqës znj. {...}, për periudhën katërmujore mars-qershor 2022, me magjistratin gjyqtar udhëheqës, znj. {...}.

2. Ky vendim i njoftohet Shkollës së Magjistraturës, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe gjyqtarëve znj. {...} dhe znj. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.03.2022)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për ngritjen dhe përbërjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelar ose për ndihmës ligjor për vitin akademik 2022-2023”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.²

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:45 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Klodian Kurushi** (anëtar)
- 3. Fatmira Luli** (anëtare)
- 4. Irena Plaku** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 6. Ridvan Hado** (anëtar)
- 7. Alban Toro** (anëtar)
- 8. Brikena Ukperaj** (anëtare)
- 9. Marçela Shehu** (anëtare)

² Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e katërta sipas rendit të ditës.

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Ilir Rusi*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të shërbimeve juridike dhe marrëdhënieve me jashtë.*
- 3. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Lorena Gerverni, Drejtore e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Rezarta Taushani, Këshilltare pranë Njësisë Mbështetëse të Komisioneve.*
- 8. Rudina Palloj, Këshilltare pranë Njësisë Mbështetëse të Komisioneve.*
- 9. Staf administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për ngritjen dhe përbërjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelar ose për ndihmës ligjor për vitin akademik 2022-2023”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin tjetër i cili ka të bëjë me ngritjen dhe përbërjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelar ose për ndihmës ligjor, për vitin akademik 2022-2023.

Siç jeni në dijeni, çdo vit, Këshilli i Lartë Gjyqësor mban detyrimin ligjor, por edhe në zbatim të rregullores që ne kemi miratuar, për ngritjen e një Komisioni të Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelarët dhe për ndihmësit ligjorë. për vitin akademik 2022-2023. Komisioni i Përkohshëm përbëhet nga tre anëtarë (2

anëtarë gjyqtarë dhe 1 anëtar jogjyqtar), të cilët në fakt ne i zgjedhim kryesisht me mirëkuptim mes njëri-tjetrit ose në rast të kundërt, me short.

Ajo që unë do doja në fakt që t'i propozoja Këshillit, duke parë edhe ngarkesën e Komisioneve dhe të relatorëve, do të propozoja (pasi edhe u konsultova), që në këtë përbërje, nga radhët e anëtarëve jogjyqtarë, zotin Ilir Rusi. Nga radhët e anëtarëve gjyqtarë do të propozoja zotin Ridvan Hado dhe znj. Irena Plaku, - nëse për ju vlerësohet i drejtë propozimi, ndryshe kalojmë në procedurën e shortit.

Jeni dakord?

Irena Plaku: Dakord.

Marçela Shehu: Nëse janë dakord edhe vetë anëtarët, dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Naureda Llagami: Me Ilirin e kam konfirmuar në telefon.

Atëherë, e miratojmë projekt-aktin me këtë propozim?

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Brikena Ukperaj: Dakord. Vetëm se doja të saktësoja që në pikën 2 të projektvendimit që na keni paraqitur, duhet të hiqet togfjalëshi "të cilët zgjidhen pas zhvillimit të procedurës së shortit".

Naureda Llagami: Atëherë, me të gjithë propozimin e Brikenës që do e reflektojmë, Këshilli vendosi:

1. Ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelar ose për ndihmës ligjor për vitin akademik 2022-2023 (në vijim Komisioni i Përkohshëm).

2. Komisioni i Përkohshëm përbëhet nga tre anëtarë, 2 anëtarë gjyqtarë dhe 1 anëtar jogjyqtar. Kryetari i Komisionit të Përkohshëm caktohet nga Kryetari i Këshillit.

3. Përbërja e Komisionit të Përkohshëm, bazuar në pikën 2 të këtij vendimi është:

1. Z. Ilir Rusi;
2. Z. Ridvan Hado;
3. Znj. Irena Plaku.

4. Komisioni i Përkohshëm merr masat për përmbushjen e detyrës së tij bazuar në procedurat dhe afatet e parashikuara në Vendimin nr.424, datë 12.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.03.2022)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 15, datë 22.01.2019 “Mbi ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për vlerësimin etik dhe profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve”, të Këshillit të Lartë gjyqësor, i ndryshuar me vendimin nr.602, datë 23.12.2021”.³

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:45 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|-------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Marçela Shehu | (anëtare) |

³ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e pesta sipas rendit të ditës.

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Ilir Rusi*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të shërbimeve juridike dhe marrëdhënieve me jashtë.*
- 3. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Lorena Gerverni, Drejtore e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Rezarta Taushani, Këshilltare pranë Njësisë Mbështetëse të Komisioneve.*
- 8. Rudina Palloj, Këshilltare pranë Njësisë Mbështetëse të Komisioneve.*
- 9. Staf administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 15, datë 22.01.2019 “Mbi ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për vlerësimin etik dhe profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve”, të Këshillit të Lartë gjyqësor, i ndryshuar me vendimin nr.602, datë 23.12.2021”.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër i cili ka ardhur si shkak i përtëritjes së Këshillit me dy anëtarë të rinj. Tashmë në Këshill, në vend të zotit {...} dhe të zotit {...}, janë zoti Ilir Rusi dhe zonja Yllka Rupa. Ky ndryshim i përbërjes së Këshillit, afekton gjithashtu edhe ndryshimin e Komisionit të Përkohshëm për vlerësimin etik dhe profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, Komision i cili është ngritur me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Çfarë mendimi keni për propozimet për ngritjen e këtij Komisioni?

Dritan, ti si kryetar i Komisionit?

Dritan Hallunaj: Faleminderit!

Propozoj zotin Rusi. Nuk kam ndonjë propozim tjetër.

Nëse ndonjë nga anëtarët mund të ketë ndonjë propozim tjetër?!

Brikena Ukperaj: Mos duhet të ruajmë raportin dy gjyqtarë, tre jogjyqtarë? Sepse në Komision jeni ju, është zoti Kurushi, është edhe zoti Hado.

Dritan Hallunaj: Po, aktualisht është zoti Kurushi, zoti Hado dhe unë.

Unë propozova zotin Rusi dhe një tjetër mund ta propozojë një anëtar tjetër.

Naureda Llagami: Thjesht kam merakun e shpërndarjes së ngarkesës së gjithsecilit, duke qenë se e kemi periudhë intensive pune. Duhet të shohim edhe ngarkesat. Unë si kryetare e kam të pamundur që të jem duke qenë se janë akte individuale.

Marçela Shehu: Mbase del ndonjë nga anëtarët vullnetar.

Naureda Llagami: S'po del. Kohë po i japim.

Zotin Rusi e caktuam.

Dritan Hallunaj: Meqë ka qenë Zëvendëskryetari i tillë, e përmenda. Tjetri të dalë një vullnetar.

Naureda Llagami: Yllka, do dalësh vullnetare?

Ose Fatmira, ose Albani.

Yllka Rupa: Dakord.

Naureda Llagami: Okej!

Atëherë, propozimet janë:

Në vend të zotit Qoku të jetë zoti Rusi dhe në vend të zotit Muharremaj të jetë zonja Rupa. Jemi dakord?

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord. (*Sipas konfirmimit të saj me e-mail, pasi nga audio nuk është bërë e mundur të dëgjohet vota, ndërsa vërehet nga pamja vizive e dritares së kësaj mbledhjeje në platformë, që mikrofonin e zonjës Rupa pulson në momentin e votimit. Për efekt dokumentimi, konfirmimi i votës me e-mail gjendet bashkëlidhur procesverbalit të siglosur).*

Klodian Kurushi: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Ndryshimin e pikës 1 të vendimit nr. 15, datë 22.01.2019, të ndryshuar të Këshillit të Lartë Gjyqësor si më poshtë:

“Ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të subjekteve të tjera të rivlerësimit, me këtë përbërje:

1. Z. Dritan Hallunaj – kryetar;
2. Z. Ilir Rusi – anëtar;
3. Z. Klodian Kurushi – anëtar;
4. Znj. Yllka Rupa – anëtare;
5. Z. Ridvan Hado – anëtar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.03.2022)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e zgjedhjes së anëtarit në vendin vakant të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor”.⁴

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:45 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | <i>(kryetare)</i> |
| 2. Klodian Kurushi | <i>(anëtar)</i> |
| 3. Fatmira Luli | <i>(anëtare)</i> |
| 4. Irena Plaku | <i>(anëtare)</i> |
| 5. Dritan Hallunaj | <i>(anëtar)</i> |
| 6. Ridvan Hado | <i>(anëtar)</i> |
| 7. Alban Toro | <i>(anëtar)</i> |
| 8. Brikena Ukperaj | <i>(anëtare)</i> |
| 9. Marçela Shehu | <i>(anëtare)</i> |
| 10. Yllka Rupa | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. ***Ilir Rusi.***

⁴ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e para sipas rendit të ditës.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të shërbimeve juridike dhe marrëdhënieve me jashtë.*
3. *Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Lorena Gerveni, Drejtore e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
5. *Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
7. *Rezarta Taushani, Këshilltare pranë Njësisë Mbështetëse të Komisioneve.*
8. *Rudina Palloj, Këshilltare pranë Njësisë Mbështetëse të Komisioneve.*
9. *Staf administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e zgjedhjes së anëtarit në vendin vakant të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor”.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës, i cili ka të bëjë me miratimin e zgjedhjes së anëtarit në vendin vakant të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor.

Siç jeni në dijeni, Këshilli, pasi verifikoi të gjithë gjyqtarët dhe pasi miratoi listën e kandidatëve për në Kolegjin Zgjedhor, dje hodhi shortin dhe shorti i ra zonjës {...}.

Ligji kërkon që ne të miratojmë me vendim të Këshillit zonjën {...}, si anëtare në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor dhe më pas, po ditën e sotshme do të zhvillohet edhe ceremonia e betimit.

Kështu që, i propozoj Këshillit që të vendosi miratimin e zgjedhjes së zonjës {...} në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Të miratojë zgjedhjen e anëtarit për plotësimin e vendit vakant në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...}.

2. Znj. {...} delegohet në këtë detyrë deri në përfundim të mandatit 4-vjeçar të anëtareve të miratuar me vendimin nr.293, datë 09.09.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.03.2022)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 7, datë 17.01.2022 “Për përbërjen e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, për vitin 2022”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:45 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Ilir Rusi*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe marrëdhënieve me jashtë.

3. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.

4. Lorena Gerverni, Drejtore e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.

5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.

6. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.

7. Rezarta Taushani, Këshilltare pranë Njësisë Mbështetëse të Komisioneve.

8. Rudina Palloj, Këshilltare pranë Njësisë Mbështetëse të Komisioneve.

9. Staf administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 7, datë 17.01.2022 “Për përbërjen e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, për vitin 2022”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen e radhës që ka të bëjë me një ndryshim në vendimin nr. 7, datë 17.01.2022 “Për përbërjen e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, për vitin 2022”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Shkaku dhe arsyeja për ndryshimin e këtij vendimi ka të bëjë me faktin e ripërtëritjes së Këshillit. Duke qenë se anëtar zëvendësues, pranë këtij Komisioni të Përkohshëm, ishte zoti {...}, dhe si i tillë me mbarimin e mandatit të zotit {...} është detyrë e Këshillit që të caktojë një anëtar zëvendësues për këtë Komision.

Siç parashikon edhe ligji, në rastin konkret zoti Muharremaj ka qenë pjesë e anëtarëve jogjyqtarë në Këshill, gjithashtu ligji parashikon që kjo procedurë do të kryhet me short.

Do të ftoja administratën të procedonte me hedhjen e shortit.

(Anëtarët jogjyqtarë që do të marrin pjesë në short janë zoti Ilir Rusi dhe zonja Yllka Rupa, pasi dy anëtarët e tjerë jogjyqtarë zoti Alban Toro dhe zonja Fatmira Luli aktualisht janë pjesë e Komisionit.)

Procedura e shortit si më poshtë:

Në një vazo qelqi futen shiritat e letrës me dy emrat e anëtarëve jogjyqtarë të cilët janë zoti Ilir Rusi dhe zonja Yllka Rupa.

Nga procedura e shortit rezultoi i përzgjedhur anëtari jogjyqtar, zoti Ilir Rusi, i cili do të zëvendësojë ish-anëtarin e Këshillit z. {...}.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Jeni dakord? Votojmë projekt-aktin?

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Ndryshimin e pikës 1 të vendimit nr. 7, datë 17.01.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor si më poshtë:

1. Përbërja e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve Kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari (KPSHA), për vitin kalendarik 2022, është si më poshtë:

1. Znj. Fatmira Luli – Kryetare;
2. Z. Dritan Hallunaj – anëtar;
3. Z. Alban Toro – anëtar.

Anëtarë zëvendësues të këtij Komisioni të Përkohshëm janë:

1. Z. Klodian Kurushi – anëtar;

2. Z. Ilir Rusi – anëtar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.03.2022)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative dhe për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 535, nr. 536 dhe nr. 537, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:45 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|-------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Marçela Shehu | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Ilir Rusi*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të shërbimeve juridike dhe marrëdhënieve me jashtë.*
- 3. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Lorena Gerveni, Drejtore e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Rezarta Taushani, Këshilltare pranë Njësisë Mbështetëse të Komisioneve.*
- 8. Rudina Palloj, Këshilltare pranë Njësisë Mbështetëse të Komisioneve.*
- 9. Staf administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative dhe për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 535, nr. 536 dhe nr. 537, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Naureda Llagami: Kalojmë më tej në projekt-aktet që vijnë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, që kanë të bëjnë me verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative dhe për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 535, nr. 536 dhe nr. 537, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit.

Për më shumë detaje fjalën ia jap zotit Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Më herët me vendimet nr. 535, nr. 536 dhe nr. 537, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur hapja e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë përkatësisht në fushën e të drejtës administrative dhe dy në fushën e së drejtës civile.

Një nga kandidatet për këto pozicione ka qenë edhe zonja {...} dhe në këtë kuadër, me vendimin nr. 26, datë 17.01.2022 nga ana e Këshillit është vendosur fillimi i procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtarë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, që kanë aplikuar për pozicionet e lira nr. 535, nr. 536 dhe nr. 537, datë 17.11.2021.

Me cilësinë e relatorit kam administruar aktet për të verifikuar plotësimin e kriterëve formale të parashikuara nga nenet 8/3, 47/4, 48/8, të ligjit për statusin dhe nga administrimi ka rezultuar se kandidatja {...} deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë, rezulton të ketë mbi pesëmbëdhjetë vjet përvojë të përgjithshme profesionale, si gjyqtare në gjykatën e shkallës së parë, si dhe mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e së drejtës administrative si dhe në fushën e së drejtës civile. Gjithashtu, nga aktet nuk u verifikua ndonjë masë disiplinore apo papajtueshmëri ambientale në rastin e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë.

Në këto kushte, relatori pasi kaloi në Komision relacionin, ju propozon këtë projektvendim përkatës, në dispozitivin e të cilit ju propozohet të miratoni:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative dhe për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 535, nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative dhe për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 535, nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toro!

Ftoj kolegët për të votuar mbi projekt-aktin, nëse nuk ka ndonjë diskutim apo koment.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Verifikimin e plotësimin nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative dhe për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 535, nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative dhe për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 535, nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.03.2022)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative dhe për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 535, nr. 536 dhe nr. 537, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:45 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|-------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Marçela Shehu | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Ilir Rusi*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të shërbimeve juridike dhe marrëdhënieve me jashtë.*
- 3. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Lorena Gerveni, Drejtore e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Rezarta Taushani, Këshilltare pranë Njësisë Mbështetëse të Komisioneve.*
- 8. Rudina Palloj, Këshilltare pranë Njësisë Mbështetëse të Komisioneve.*
- 9. Staf administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative dhe për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 535, nr. 536 dhe nr. 537, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me verifikimin e plotësimit nga kandidatja zonja {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë. Për më shumë detaje, prapë fjalën ia jap zotit Toro.

Alban Toro: Edhe kandidatja {...} ka qenë një nga kandidaturat për pozicionet e hapura në Gjykatën e Lartë në fushën e së drejtës administrative dhe dy në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 535, nr. 536 dhe nr. 537, datë 17.11.2021.

Gjithashtu me vendimin nr. 26, datë 17.01.2022 kanë filluar procedurat e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtarë në Gjykatën e Lartë, për këto kandidatë.

Me cilësinë e relatorit kam administruar informacionet e dhura për të konfirmuar plotësimin e kriterëve formale të parashikuara në nenet 8/3, 47/4, 48/8, të ligjit për statusin. Nga vlerësimi i këtyre akteve ka rezultuar se zonjë {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë për pozicionet e lira të shpallura për tre pozicionet, rezulton të ketë mbi pesëmbëdhjetë vjet përvojë të përgjithshme profesionale, si gjyqtare në gjykatën e shkallës së parë, gjithashtu ajo rezulton të ketë mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e së drejtës administrative si dhe në fushën e së drejtës civile. Nga aktet nuk rezulton që kjo kandidatë të ketë ndonjë masë disiplinore apo të vërtetohet një situatë papajtueshmërie ambientale në rastin hipotetik të ngritjes së saj në detyrë në Gjykatën e Lartë.

Kështu që, me cilësinë e relatorit, pasi kam kaluar relacionin Komisionit, ju propozohet projektvendimi përkatës, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative dhe për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 535, nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative dhe për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 535, nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toro!

Ftoj kolegët për të miratuar projekt-aktin.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative dhe për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 535, nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative dhe për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 535, nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Duke genë se zoti Kurushi kërkon paraprakisht pak kohë për trajtimin e çështjes vijuese në rendin e ditës, Këshilli vijon me trajtimin e çështjeve të tjera të rendit të ditës, duke shtuar edhe një çështje në rend e cila ka të bëjë me caktim gjyqtarësh në gjykata të tjera (për shkak të karakterit urgjent që ka kërkesa). Çështjet ku zoti Kurushi është relator trajtohen të fundit, duke ndryshuar kështu renditjen e çështjeve në rend.*

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.03.2022)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e relatorit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të papërfunduara për shkak të përfundimit të qëndrimit në detyrë të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. {...}”, relatore znj. Brikena Ukperaj.⁵

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:45 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Klodian Kurushi* (anëtar)
3. *Fatmira Luli* (anëtare)
4. *Irena Plaku* (anëtare)
5. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
9. *Marçela Shehu* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

⁵ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 11-ta në rendin e ditës.

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Ilir Rusi**.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe marrëdhënieve me jashtë.**
- 3. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Lorena Gerveni, Drejtore e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
- 5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 7. Rezarta Taushani, Këshilltare pranë Njesisë Mbështetëse të Komisioneve.**
- 8. Rudina Palloj, Këshilltare pranë Njesisë Mbështetëse të Komisioneve.**
- 9. Staf administrativ i KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e relatorit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të papërfunduara për shkak të përfundimit të qëndrimit në detyrë të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. {...}”, relatore znj. Brikena Ukperaj.

Naureda Llagami: Do propozoja që të vijonim me aktin e radhës, që ka të bëjë me caktimin e relatorit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të papërfunduara për shkak të përfundimit të qëndrimit në detyrë të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. {...}”. Për më shumë detaje fjalën ia jap zonjës Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit, zonja Kryetare!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në zbatim të nenit 171 pika 5 të Ligjit për Statusin, i ndryshuar, dhe të gjithë akteve nënligjore që plotësojnë skemën e vlerësimit të gjyqtarëve, duke filluar në vitin 2020 dhe duke vazhduar në vitin 2021 dhe në vitin 2022, ka filluar me prioritet procesin e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi për 62 (gjashtëdhjetë e dy) gjyqtarë, për 43 (dyzet e tre) nga të cilët raportet e vlerësimit janë miratuar nga Këshilli, për 1 (një) gjyqtar është verifikuar nga Komisioni plotësimi i

procedurës dhe dosjes së vlerësimit dhe procedura vijon pranë relatorit me përgatitjen e projektraportit të vlerësimit, për 1 (një) gjyqtar është vendosur nga Komisioni pezullimi i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për shkak të zgjedhjes së tij si anëtar i KLGJ, ndërkohë që vazhdojnë procedurat për vlerësimin e 17 (shtatëmbëdhjetë) gjyqtarëve të tjerë, për 7 (shtatë) nga të cilët ka qenë relator në procedurat e vlerësimit z. {...}.

Në zbatim të programit të vlerësimeve të miratuar për vitin 2021, Këshilli ka filluar gjatë vitit 2021 procedurat e vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017-2019 për 25 (njëzet e pesë) gjyqtarë, nga të cilët kjo procedurë vlerësimi ka përfunduar për njërin prej tyre. Ndërkohë për 2 (dy) gjyqtarë Komisioni ka vendosur pezullimin e procedurave të vlerësimit, ndërkohë që procedurat e vlerësimit vijojnë ende për 22 (njëzet e dy) gjyqtarë, për 10 (dhjetë) nga të cilët ka qenë relator në procedurat e vlerësimit z. {...}.

Me vendimin nr.78, datë 02.03.2022, Këshilli ka deklaruar mbarimin e mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. {...} dhe përfundimin e qëndrimit të tij në detyrë. Në këto kushte është e nevojshme caktimi i një relatori të ri në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të papërfunduara prej tij si relator, konkretisht në 7 (shtatë) procedura gradimi dhe në 10 (dhjetë) procedura vlerësimi 2017-2019.

Në zbatim të nenit 89 të Ligjit për Statusin, si dhe neneve 12 të Vendimeve të Këshillit nr.263/2019 dhe nr.194/2021, caktimi i relatorit të ri duhet të bëhet me short midis anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit Etik dhe Profesional, i cili pas vendimit të Këshillit nr. 79, datë 02.03.2022, përbëhet nga anëtarët znj.Brikena Ukperaj; znj.Irena Plaku dhe znj. Yllka Rupa.

Duke marrë në konsideratë prioritetet në vlerësime dhe shpërndarjen e barabartë të punës mes anëtarëve, Komisioni i propozon Mbledhjes Plenare, si më poshtë:

Organizimin e 2 procedurave të veçanta shortimi për përzgjedhjen e relatorit.

Në procedurën e parë të organizohet shorti për përzgjedhjen e relatorit në procedurat e vlerësimit të gjyqtarëve të konsideruara si vlerësime prioritare për shkak të kandidimit për ngritje në detyrë, ku përfshihen gjyqtarët (përkrah emrit të gjyqtarit është edhe lloji i procedurës së vlerësimit):

1. {...} – Gradim;
2. {...} – Gradim;
3. {...} – Gradim;

4. {...} – vlerësim 2017 – 2019;
5. {...} – vlerësim 2017 – 2019;
6. {...} – vlerësim 2017 – 2019.

Në procedurën e dytë të organizohet shorti për përzgjedhjen e relatorit në procedurat e tjera të vlerësimit për gjyqtarët :

1. {...} – Gradim;
2. {...} – Gradim;
3. {...} – Gradim;
4. {...} – Gradim;
5. {...} – vlerësim 2017 – 2019;
6. {...} – vlerësim 2017 – 2019;
7. {...} – vlerësim 2017 – 2019;
8. {...} – vlerësim 2017 – 2019;
9. {...} – vlerësim 2017 – 2019;
10. {...} – vlerësim 2017 – 2019;
11. {...} – vlerësim 2017 – 2019.

Në procedurën e parë të shortimit për përzgjedhjen e relatorit në procedurat e vlerësimit të gjyqtarëve të konsideruara si vlerësime prioritare do të marrin pjesë me një shpërndarje të barabartë pune (nga 2 vlerësime secili) të 3 anëtarët e Komisionit. Ndërsa në procedurën e dytë të shortimit për përzgjedhjen e relatorit në procedurat e tjera të vlerësimit për gjyqtarët, duke pasur parasysh ngarkesën aktuale të punës të anëtarëve të komisionit, si dhe me duke mbajtur parasysh, për aq sa është e mundur, barazinë e shpërndarjes së punës në këto vlerësime të reja, mendimi i Komisionit ka qenë që të marrin pjesë 2 nga anëtarët e Komisionit, konkretisht znj. Irena Plaku dhe znj. Yllka Rupa. Në një vazo më vete duhet të vendosen në procedurën e parë të shortit 2 shirita letre me emrin e secilit anëtar, gjithsej 6 shirita (2 për secilin anëtar). Në procedurën e dytë të shortit duhet të vendosen në një vazo më vetë 11 shirita (5 për anëtarin znj. Irena Plaku dhe 6 për anëtarin znj. Yllka Rupa).

Në shiritat e letrës me emrat e gjyqtarëve në proces vlerësimi, të cilët duhet të vendosen në një vazo tjetër për secilën procedurë shorti, emrat e gjyqtarëve dhe krahas tyre edhe procedura e vlerësimit në të cilën përzgjidhet me short relatori, sepse ka gjyqtar të përfshirë njëkohësisht në më shumë se një procedurë vlerësimi.

Për sa më lart, nëse Këshilli është dakord, nga ana e Komisionit është përgatitur edhe projekt-akti përkatës për zëvendësimin e relatorit në procedurat e pambaruara për shkak të përfundimit të qëndrimit në detyrë të zotit {...}.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet caktimi i relatorit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional (gradimin).

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet caktimi i relatorit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të papërfunduara, që i përkasin periudhës 2017-2019.

Për të saktësuar – Projektvendimi është detajuar dhe është formuluar mbi bazën e llojit të procedurës. Në pikën e parë është për sa i përket procedurës së gradimit dhe në pikën e dytë është periudha 2017-2019. Ndërkohë që shorti do të organizohet sipas prioriteteve që ka Këshilli në vlerësimet e gjyqtarëve. Prandaj duhet të kihet kujdes për të korresponduar emri përkatës me llojin e procedurës. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Ukperaj!

Vijojmë me procedurën e shortit.

Fillimisht do të hidhet shorti për nivelin e vlerësimit të gradimit të gjyqtarëve?

Brikena Ukperaj: Fillimisht për përzgjedhjen e relatorit në procedurat prioritare dhe në këto procedura prioritare mund të ketë edhe gradim edhe vlerësime 2017 – 2019. Por në momentin që përzgjidhet relatori duhet që të përcaktohet në vendim emri përkatës. Shorti është mbi bazën e prioriteteve. Projektvendimi është propozuar mbi bazën e procedurës. Është e njëjta gjë siç edhe kur bëmë për zonjën Kadi.

Naureda Llagami: Nga ana e administratës të fillojë procesi.

Procedura e shortit të parë si më poshtë:

Në enën e parë të qelqit futen me radhë shiritat e letrës me emrat e tre anëtarëve të Komisionit: Dy shirita letre me emrin e zonjës Brikena Ukperaj, dy shirita letre me emrin e zonjës Irena Plaku dhe dy shirita letre me emrin e zonjës Yllka Rupa.

Në enën e dytë të qelqit futen me radhë shiritat e letrës me emrat e magjistratëve, ku përbri emrit është e cituar edhe periudha e vlerësimit: {...} – Gradim; {...} – Gradim; {...} – Gradim; {...} – vlerësim 2017 – 2019; {...} – vlerësim 2017 – 2019; {...} – vlerësim 2017 – 2019;

Nga procedura e përzgjedhjes për shortin e parë rezultoi si më poshtë:

Për gjyqtarin z. {...} (gradimi) - Relatore znj. Yllka Rupa.

Për gjyqtaren znj. {...} (2017 – 2019) – Relatore znj. Brikena Ukperaj.

Për gjyqtarin z. {...} (2017 – 2019) – Relatore znj. Yllka Rupa.

Për gjyqtaren znj. {...} (gradimi) – Relatore znj. Irena Plaku.

Për gjyqtaren znj. {...} (gradimi) – Relatore znj. Irena Plaku.

Për gjyqtaren znj. {...} (2017 – 2019) – Relatore znj. Brikena Ukperaj.

Procedura e shortit të dytë si më poshtë:

Në enën e parë të qelqit futen me radhë shiritat e letrës me emrat e 2 anëtarëve të Komisionit: Pesë shirita letre me emrin e zonjës Irena Plaku dhe gjashtë shirita letre me emrin e zonjës Yllka Rupa.

Në enën e dytë të qelqit futen me radhë shiritat e letrës me emrat e magjistratëve, ku përbri emrit është e cituar edhe periudha e vlerësimit: {...} – Gradim; {...} – Gradim; {...} – Gradim; {...} – Gradim; {...} – vlerësim 2017 – 2019; {...} – vlerësim 2017 – 2019; {...} – vlerësim 2017 – 2019; {...} – vlerësim 2017 – 2019; {...} – vlerësim 2017 – 2019; {...} – vlerësim 2017 – 2019; {...} – vlerësim 2017 – 2019;

Nga procedura e përzgjedhjes për shortin e dytë rezultoi si më poshtë:

Për gjyqtarin z. {...} (gradimi) – Relatore znj. Yllka Rupa.

Për gjyqtaren znj. {...} (gradimi) – Relatore znj. Yllka Rupa.

Për gjyqtaren znj. {...} (2017 – 2019) – Relatore znj. Irena Plaku.

Për gjyqtaren znj. {...} (2017 – 2019) – Relatore znj. Yllka Rupa.

Për gjyqtaren znj. {...} (2017 – 2019) – Relatore znj. Yllka Rupa.

Për gjyqtaren znj. {...} (2017 – 2019) – Relatore znj. Irena Plaku.

Për gjyqtaren znj. {...} (2017 – 2019) – Relatore znj. Irena Plaku.

Për gjyqtarin z. {...} (gradimi) – Relatore znj. Yllka Rupa.

Për gjyqtaren znj. {...} (gradimi) – Relatore znj. Irena Plaku.

Për gjyqtaren znj. {...} (2017 – 2019) – Relatore znj. Yllka Rupa.

Për gjyqtaren znj. {...} (2017 – 2019) – Relatore znj. Irena Plaku.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kalojmë në votimin e projekt-aktit pas hedhjes së shortit?

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Caktimin e relatorit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, të papërfunduara për shkak të përfundimit të qëndrimit në detyrë të anëtarit të Këshillit z. {...}, si më poshtë:

- a) Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Irena Plaku.
- b) Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Yllka Rupa.
- c) Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Irena Plaku.
- d) Për gjyqtarin z. {...} – Relatore znj. Yllka Rupa.
- e) Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Irena Plaku.
- f) Për gjyqtarin z. {...} – Relatore znj. Yllka Rupa.
- g) Për gjyqtarin z. {...} – Relatore znj. Yllka Rupa.

2. Caktimin e relatorit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional, periudha e vlerësimit 2017 – 2019, të papërfunduara për shkak të mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit z. {...}, si më poshtë:

- a) Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Irena Plaku.
- b) Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Brikena Ukperaj.
- c) Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Brikena Ukperaj.
- d) Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Irena Plaku.
- e) Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Yllka Rupa.
- f) Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Yllka Rupa.
- g) Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Irena Plaku.

- h) Për gjyqtarin z. {...} – Relatore znj. Yllka Rupa.
- i) Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Irena Plaku.
- j) Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Yllka Rupa.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.03.2022)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Projektvendim “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, në vijim të vlerësimit me përparësi të gjyqtarëve për të cilët janë dërguar dosjet nga organet e rivlerësimit”, relatore znj. Brikena Ukperaj.⁶

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:45 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|--------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>9. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |

⁶ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 12-ta në rendin e ditës.

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Ilir Rusi*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të shërbimeve juridike dhe marrëdhënieve me jashtë.*
- 3. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Lorena Gerverni, Drejtore e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Rezarta Taushani, Këshilltare pranë Njesisë Mbështetëse të Komisioneve.*
- 8. {...}, Këshilltare pranë Njesisë Mbështetëse të Komisioneve.*
- 9. Staf administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

10. Projektvendim “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, në vijim të vlerësimit me përparësi të gjyqtarëve për të cilët janë dërguar dosjet nga organet e rivlerësimit”, relatore znj. Brikena Ukperaj.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin tjetër, që edhe ky është projekt-akt i Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale që ka të bëjë me “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”. Për më shumë detaje fjalën ia jap znj. Brikena Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit, zonja Kryetare!

Ky projekt-akt është përgatitur në vijim të trajtimit me përparësi të vlerësimit me qëllim gradimi të gjyqtarëve për të cilët vendimi i konfirmimit në detyrë merr formë të

prerë dhe dosjet me aktet e vlerësimit profesional dërgohen nga organet e rivlerësimit kalimtar.

Në vijim të bashkëpunimit me këtë organ, në Këshill kanë mbërritur dosjet me aktet e vlerësimit profesional për gjyqtarët {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}, vendimet respektive për të cilët kanë marrë formë të prerë.

Në këtë kuadër, i propozohet mbledhjes plenare sot filli i procedurës së vlerësimit me qëllim gradimi për të gjashtë gjyqtarët si dhe përzgjedhja me short e relatorit duke siguruar një barazi në shpërndarjen e punës midis të tre anëtarëve të Komisionit, si dhe midis dy nëpunësve përgjegjës të vlerësimit të angazhuar tashmë në kuadër të procesit të vlerësimit etik dhe profesional: znj. Esmerilda Habili dhe znj. Gilda Hoxha.

Duke qenë se kemi 6 gjyqtarë, gjatë procedurës së shortit do të vendosen 2 herë emrat e secilit anëtar të Këshillit dhe njëkohësisht tre herë emrat e secilit prej nëpunësve përgjegjës të vlerësimit, për të siguruar një barazi në shpërndarje. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Ftoj administratën për të vijuar me procedurën e hedhjes së shortit për caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës.

Procedura e shortit si më poshtë:

Në enën e parë të qelqit futen me radhë shiritat e letrës me emrat e tre anëtarëve të Komisionit: Dy shirita letre me emrin e zonjës Brikena Ukperaj, dy shirita letre me emrin e zonjës Irena Plaku dhe dy shirita letre me emrin e zonjës Yllka Rupa.

Në enën e dytë të qelqit futen shiritat e letrës me emrat e nëpunësve përgjegjës të vlerësimit: tre shirita letre me emrin e znj. Gilda Hoxha dhe tre shirita letre me emrin e znj. Esmerilda Habili.

Në enën e tretë të qelqit futen me radhë shiritat e letrës me emrat e gjyqtarëve si më poshtë: z. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, z. {...} dhe znj. {...}.

Pas hedhjes së shortit rezulton si poshtë:

1. Për gjyqtarin z. {...} – Relatore znj. Yllka Rupa – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

2. Për gjyqtarin z. {...} – Relatore znj. Brikena Ukperaj – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

3. Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Yllka Rupa – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

4. Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Irena Plaku – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

5. Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Irena Plaku – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

6. Për gjyqtarin z. {...} – Relatore znj. Brikena Ukperaj – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

Naureda Llagami: Atëherë, ftoj kolegët nëse nuk kanë diskutime, për miratimin e projekt-aktit dhe shortit të hedhur.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

I. Fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, për të cilët janë dorëzuar në vijim nga organet e rivlerësimit, dosjet me aktet e vlerësimit profesional.

II. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, si më poshtë:

1. Për gjyqtarin z. {...} – Relatore znj. Brikena Ukperaj – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

2. Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Irena Plaku – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

3. Për gjyqtarin z. {...} – Relatore znj. Brikena Ukperaj – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

4. Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Yllka Rupa – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

5. Për gjyqtarin z. {...} – Relatore znj. Yllka Rupa – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

6. Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Irena Plaku – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.03.2022)

Pika 11 e rendit të ditës me objekt: Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datave: 31.01.2022, 08.02.2022, 09.02.2022, 10.02.2022, 15.02.2022, 17.02.2022 dhe 23.02.2022.⁷

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:45 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Klodian Kurushi** (anëtar)
- 3. Fatmira Luli** (anëtare)
- 4. Irena Plaku** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 6. Ridvan Hado** (anëtar)
- 7. Alban Toro** (anëtar)
- 8. Brikena Ukperaj** (anëtare)
- 9. Marçela Shehu** (anëtare)
- 10. Yllka Rupa** (anëtare)

⁷ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 13-ta në rendin e ditës.

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Ilir Rusi*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe marrëdhënieve me jashtë.*
- 3. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Lorena Gerverni, Drejtore e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Rezarta Taushani, Këshilltare pranë Njesisë Mbështetëse të Komisioneve.*
- 8. Rudina Palloj, Këshilltare pranë Njesisë Mbështetëse të Komisioneve.*
- 9. Staf administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

11. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datave: 31.01.2022, 08.02.2022, 09.02.2022, 10.02.2022, 15.02.2022, 17.02.2022 dhe 23.02.2022.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin tjetër që ka të bëjë me miratimin e procesverbaleve të mbledhjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Siç jeni në dijeni, nga ana e administratës ju janë përcjellë procesverbalet për mbledhjet me datat respektive 31 janar, 8 shkurt, 9 shkurt, 10 shkurt, 15 shkurt, 17 shkurt dhe 23 shkurt, të 2022. Nga ana juaj nuk është përcjellë ndonjë koment kështu që unë do ju ftoja për miratimin e këtij projekt-akti.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 31.01.2022, 08.02.2022, 09.02.2022, 10.02.2022, 15.02.2022, 17.02.2022 dhe 23.02.2022.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e këtyre procesverbaleve Kryetarja e Këshillit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 11 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.03.2022)

Pika 13 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për gjykimin e çështjeve gjyqësore pas përfundimit para afatit të shërbimit në skemën e delegimit nga gjyqtarja {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).⁸

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:45 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | <i>(kryetare)</i> |
| 2. Klodian Kurushi | <i>(anëtar)</i> |
| 3. Fatmira Luli | <i>(anëtare)</i> |
| 4. Irena Plaku | <i>(anëtare)</i> |
| 5. Dritan Hallunaj | <i>(anëtar)</i> |
| 6. Ridvan Hado | <i>(anëtar)</i> |
| 7. Alban Toro | <i>(anëtar)</i> |
| 8. Brikena Ukperaj | <i>(anëtare)</i> |
| 9. Marçela Shehu | <i>(anëtare)</i> |
| 10. Yllka Rupa | <i>(anëtare)</i> |

⁸ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 10-ta në rendin e ditës.

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Ilir Rusi**.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe marrëdhënieve me jashtë.**
- 3. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Lorena Gerveni, Drejtore e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
- 5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 7. Rezarta Taushani, Këshilltare pranë Njesisë Mbështetëse të Komisioneve.**
- 8. Rudina Palloj, Këshilltare pranë Njesisë Mbështetëse të Komisioneve.**
- 9. Staf administrativ i KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

13. Shqyrtimi i projektvendimit “Për gjykimin e çështjeve gjyqësore pas përfundimit para afatit të shërbimit në skemën e delegimit nga gjyqtarja {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës, i cili ka të bëjë me projektvendimin “Për gjykimin e çështjeve gjyqësore pas përfundimit para afatit të shërbimit në skemën e delegimit nga gjyqtarja {...}”. Për më shumë detaje fjalën ia jap zotit Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit, Kryetare!

Të nderuar kolegë!

Në Këshillin e Lartë Gjyqësor, janë paraqitur tre shkresa nga gjykatat e apelit Shkodër, Durrës dhe Gjykata Administrative e Apelit, përmes të cilave ngrihet shqetësimi lidhur me vijueshmërinë e gjykimit të çështjeve gjyqësore, për të cilat ka qenë e caktuar me vendimet përkatëse të KLGJ-së znj. {...}. Për këtë të fundit, me vendimin nr. 593, datë 23.12.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “Ngritjen në detyrën e gjyqtarit

të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të znj. {...}. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 01.02.2022”. Me vendimin nr. 44, datë 31.01.2022 është vendosur: “Përfundimi para afatit të shërbimit në skemën e delegimit. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 01.02.2022.”

Rrethanat e çështjes për të cilat është paraqitur relacioni dhe propozimi i projektvendimit nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës:

Gjykata e Apelit Shkodër, përmes shkresave me nr. {...} prot., datë 04.02.2022, nr. {...} prot., datë 11.02.2022 dhe nr. {...} prot., datë 14.02.2022, paraqet situatën si vijon: Gjyqtare {...}, ka 8 (tetë) çështje gjyqësore në proces gjykimi në Gjykatën e Apelit Shkodër, ku në 7 (shtatë) prej tyre është në cilësinë e anëtares së trupit gjykues dhe në 1 (një) është në cilësinë e relatores. Konkretisht (i) çështja penale nr. {...} regj., ku i pandehuri është me masë sigurie arrest në shtëpi është në proces gjykimi, shqyrtimi gjyqësor dhe është shtyrë për njoftimin e viktimës. Kjo çështje është caktuar për gjykim më datë 18.02.2022 (janë zhvilluar 12 seanca gjyqësore dhe çështja është ende në gjykim dhe nuk ka përfunduar); (ii) çështja penale nr. {...} regj., me të pandehur në gjendje të lirë, është caktuar për gjykim më datë 18.02.2022. Kjo çështje është në proces shqyrtimi gjyqësor dhe deri tani janë zhvilluar 6 seanca gjyqësore; (iii) çështja civile nr. {...} regj., është në proces gjykimi (në fazën e njohjes së vendimit të arsyetuar të ankimit të veçantë); (iv) çështja civile nr. {...} regj., është në fazën e shpalljes së vendimit dhe është shtyrë pa datë nga relatori; (v) çështja administrative civile nr. 1205 regj., për të cilën nuk është caktuar akoma data e gjykimit nga relatori i çështjes (deri tani nuk ka asnjë seancë të zhvilluar); (vi) çështja civile nr. {...} regj., është shtyrë për riçelje të shqyrtimit gjyqësor dhe seanca gjyqësore është caktuar më datë 18.02.2022; (vii) çështja penale nr. {...} regj., është në proces gjykimi dhe deri tani janë zhvilluar 7 seanca gjyqësore. Seanca e ardhshme është planifikuar më datë 18.02.2022; (viii) çështja civile nr. {...} regj., është në proces gjykimi, ku janë zhvilluar deri tani 31 seanca gjyqësore. Seanca e ardhshme është planifikuar më datë 18.02.2022.

Në lidhje me çështjet që ka pasur në shqyrtim gjyqtarja {...} në Gjykatën e Apelit Durrës ku ajo ishte deleguar për shkak të skemës së delegimit, Gjykata e Apelit Durrës ka paraqitur shkresat në Këshillin e Lartë Gjyqësor me nr. {...} prot., datë 11.02.2022, nr. {...} prot., datë 15.02.2022 dhe nr. {...} prot., datë 16.02.2022, në të cilat gjykata referon: Gjyqtare {...} ka pasur pranë Gjykatës së Apelit Durrës, (deri më datë 31.01.2022, datë në të cilën është vendosur mbarimi i afatit në skemën e delegimit) 387 çështje civile dhe

162 çështje penale të paplanifikuara për gjykim (gjithsej 549 çështje gjyqësore), si dhe 56 çështje gjyqësore (civile dhe penale) të planifikuara për gjykim dhe të shpërndara tek gjyqtarët e tjerë të Gjykatës së Apelit Durrës. Këto çështje janë në pritje të radhës dhe nuk kanë datë të planifikuar për gjykim. Ndërkohë, në vijim të informacionit të mësipërm, Gjykata e Apelit Durrës ka vënë në dijeni mbi 4 (katër) çështje gjyqësore, që sipas saj kanë nevojë për delegimin e një gjyqtari, për shkak të qenies së gjyqtares {...} anëtare e trupit gjykues (dhe papajtueshmërisë së gjyqtarëve të kësaj gjykate për gjykimin e tyre çështjeve ku ka qenë e pranishme si anëtare e trupit gjykues zonja {...}. Çështjet janë të integruara në pjesën e relacionit. Janë çështje të natyrës penale dhe civile.

Gjykata Administrative e Apelit, përmes shkresës nr. {...} prot., datë 19.01.2022 ka vënë në dijeni Këshillin e Lartë Gjyqësor, se gjyqtarja {...}, ka qenë pjesë e trupit gjykues në çështjen administrative nr. {...} regj. themeltar, datë 17.01.2020, me palë paditëse Shoqëria “{...}” sh.p.k., {...}, i paditur Këshilli i Bashkisë Krujë, me objekt (lexohet objekti), pra kundërshtohet akti normativ. Lidhur me gjykimin e kësaj çështjeje, gjykata ka paraqitur kërkesë për delegim gjyqtari, në kushtet kur gjyqtarja {...} ka njoftuar me e-mail Gjykatën Administrative të Apelit në datë 14.02.2022, se është emëruar pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, dhe se pas datës 01.02.2022 nuk mund të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjeve në të cilat ajo ka qenë e deleguar.

Kuadri ligjor mbi të cilin mbështetet relacioni dhe propozimet tona është Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; vendimi nr. 22, datë 07.02.2019 i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”.

Vlerësimi lidhur me çështjen:

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 593, datë 23.12.2021 vendosi “ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të znj. {...}. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 01.02.2022.” Si rrjedhim i këtij akti, KLGJ me vendimin nr. 44, datë 31.01.2022 vendosi: “Përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit, për gjyqtaren znj. {...}. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 01.02.2022.”

Vendimi për përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit për znj. {...}, u mor në kushtet e ngritjes së saj në detyrë dhe caktimit të gjyqtares në mënyrë të përhershme në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Në nenin 14, të Rregullores “Për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, miratuar me vendimin nr. 22, datë 07.02.2019 të Këshillit, përcaktohen rastet e përfundimit të shërbimit në skemën e delegimit përpara afatit. Rastet janë të parashikuara dhe të integruara në relacion dhe unë nuk po i përmend për efekt kohe.

Në Komision u ngritën dy shqetësime ose dy probleme që i referoheshin situatës së gjyqtarës {...} pas daljes së saj nga skema e delegimit dhe emërimit si gjyqtare në Gjykatën e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Këto shqetësime lidhen me faktet:

1) Nëse gjyqtarja {...}, si gjyqtare e skemës së delegimit do vazhdojë të gjykojë çështjet e skemës edhe pas ndërprerjes para kohe të saj?

2) Apo gjyqtarja {...}, pas ngritjes në detyrë dhe përfundimit para kohe të afatit të skemës së delegimit, nuk do gjykojë më asnjë çështje, për të cilat ka qenë caktuar si gjyqtare e kësaj skeme?

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, referuar praktikës së Këshillit në rastet e ndërprerjes së Skemës së Delegimit për gjyqtarët e përfshirë në delegim, vlerëson, në mbështetje edhe të praktikës, pozicionin e “gjyqtarit natyral” në vijimin e gjykimit të një çështjeje gjyqësore të caktuar me short për t’u gjykuar nga ana e gjyqtarit. Në rastin konkret, gjyqtarja {...} është caktuar me short përzgjedhës për të gjykuar çështjet gjyqësore të përmendura më lart. Shorti është hedhur sipas rastit nga KLGJ për çështjet që janë në gjykimin përpara Gjykatave të Apelit Administrativ dhe apelit Shkodër, si dhe nga kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Durrës, për çështjet që janë në gjykim përpara kësaj gjykate. Në këtë kuptim, në vlerësimin e Komisionit, edhe pas emërimit të gjyqtarës Zj. {...} në Gjykatën e Posaçme të Apelit, ajo vazhdon të plotësojë kushtet ligjore për gjykimin e të gjitha çështjeve gjyqësore të cituara më lart. Ndërprerja e gjykimeve të filluara, për shkak të emërimit të saj në Gjykatën e Posaçme të Apelit, nuk është një situatë e parashikuar shprehimisht në ligj.

Në rastin kur nuk ekzistojnë shkaqet ligjore të heqjes dorë nga gjykimi, të përjashtimit të gjyqtarit apo shkaqe të tjera ligjore që lidhen me kushtet që plotëson gjyqtari për gjykimin e një çështjeje gjyqësore konkrete, Komisioni vlerëson se parimi i “gjyqtarit natyral” në vijimin e gjykimit të çështjeve gjyqësore të nisura nga ana e tij duhet të gjejnë zbatim edhe në rastin e gjykimit të çështjeve gjyqësore, ku në përbërje të trupit gjykues në pozicionin e relatores ose anëtares është gjyqtarja {...}.

Ndërkohë, sa i përket çështjeve të adresuara në shkresat e cituara më lart nga ana e gjykatave, të cilat, nuk janë të planifikuara ende për gjykim, pra nuk ka filluar ende procesi gjyqësor ndaj këtyre çështjeve dhe gjyqtarja {...} nuk është prezantuar me palët gjatë procesit gjyqësor dhe nuk është marrë pëlqimi i palëve nëse ata dakordësohen me pranim ose jo të gjyqtarës {...} si gjyqtare në gjykimin e çështjeve të tyre, në këtë rast Komisioni vlerëson se ato do t'i nënshtrohen rregullit të përgjithshëm të rishortimit të tyre, për sa kohë gjyqtarja {...} nuk është “gjyqtare natyrale” në vijimin e mëtejshëm të gjykimit të këtyre çështjeve, për sa kohë ato nuk kanë filluar ende të shqyrtohen.

Për sa më sipër, është përgatitur edhe projekt-akti përkatës, në pikën e parë të të cilit parashikohet rregullimi i situatës, duke përcaktuar që gjyqtarja {...}, do vijojë të gjykojë çështjet në të cilat ka qenë e caktuar si gjyqtare e skemës së delegimit, të cilat janë në seancë gjyqësore. Ndërkohë, në pikën e dytë të tij, parashikohet që, lidhur me çështjet e tjera, të cilat nuk janë të planifikuara akoma për gjykim, vlerësohet që të përdoret rregulli i përgjithshëm i shortimit të tyre.

Gjithashtu, nëse Këshilli do vlerësojë që gjyqtarja {...} nuk duhet të vijojë me gjykimin e çështjeve, pas ndërprerjes së shërbimit në skemë delegimi, është përgatitur akti në zbatim të vullnetit të Këshillit.

Në pikën e tretë parashikohet njoftimi i këtij vendimi gjyqtarës {...} si dhe gjykatave respektive, që kanë paraqitur shqetësimin në shkresat e cituara më lart.

Bashkëlidhur do të gjeni edhe projektvendimin në dy alternativat e propozuara në relacionin e parashtruar më lart. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Kurushi!

Ftoj kolegët lidhur me dy alternativat që ka parashtruar Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, për të vlerësuar lidhur me qëndrimin e Këshillit në këtë rast.

Po, Brikena!

Brikena Ukperaj: Faleminderit!

Mbaj qëndrimin që gjyqtarja {...} duhet të dorëzonte detyrën në datën 01.02.2022, dhe ky konkluzion bazohet jo vetëm në vendimmarrjet e Këshillit, por edhe në konceptin mbi përfundimin e skemës së delegimit dhe për këtë shkak ajo duhet të dorëzonte të gjitha çështjet që ka pasur për shqyrtim. Ky propozim i imi, edhe pse bashkohet me alternativën e dytë të përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, në fakt, në

vlerësimin tim, nuk duhet të vijë si një akt i veçantë, por duhet të vijë si një shtesë në vendimin e përfundimit të skemës së delegimit për gjyqtaren {...}.

Për t'i marrë gjërat në rend kronologjik, po citoj se:

Gjyqtarja {...} ka qenë gjyqtare e skemës së delegimit, afati i cili i është zgjatur dy herë. Gjatë kohës që ka qenë në skemë delegimi, Këshilli ka miratuar ngritjen e saj në detyrë në Gjykatën e Apelit të Posaçëm kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe në këtë vendim, Këshilli i ka dhënë efekte të vonuara ngritjes në detyrë, jo në datën e miratimit të ngritjes në detyrë, por në një datë më të mëvonshme, që ka qenë data 1 shkurt 2022. Referuar relacionit që shoqëron këtë vendim, rezulton se një nga shkaqet për të cilat i është dhënë efekt i vonuar, veç funksionalitetit të gjykatave, numrit të gjyqtarëve, volumit të çështjeve që ka pasur, ka qenë (sipas relacionit citohet pika 9): Dhënia e efektit të mëvonshëm me qëllim lënien e një periudhe të mjaftueshme gjatë së cilës zonja {...} do të duhet të dorëzojë detyrën pranë Gjykatës së Apelit Durrës dhe Gjykatës së Apelit Shkodër.

Mbi bazën e këtij relacioni, ne kemi votuar për ngritjen në detyrë të zonjës {...}, duke i dhënë efekt të vonuar vendimmarrjes së Këshillit, çka nënkuptonte që gjatë kësaj periudhe, deri në datën 1 shkurt, ajo duhet të përfundonte gjykimin e çështjeve që kishte për shqyrtim (jo ndoshta të gjitha çështjet). Mbas kësaj date, sigurisht që duhet të dorëzonte detyrën. Ky vendim, jo pa shkak i është njoftuar të gjitha gjykatave, pra i është njoftuar të gjitha gjykatave në të cilat gjyqtarja {...} ka qenë e caktuar (apeli Durrës, Shkodër), ka qenë madje e caktuar sipas relacionit edhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (ku ka pasur tre çështje për shqyrtim), Gjykatës së Fierit dhe ndoshta Gjykatës së Apelit Administrativ.

Lënia e një afati të mëvonshëm është bërë pikërisht për këtë shkak, që gjyqtarja të përfundonte çështjet. Nëse gjyqtarja duhet t'i gjykonte të gjitha çështjet, nuk kishte pse Këshilli të vendoste një afat të mëvonshëm për fillimin e efekteve të ngritjes në detyrë dhe nuk kishte pse duhet të njoftonte të gjitha gjykatat për këtë vendimmarrje të Këshillit. Pra, pavarësisht se nuk ka një disponim me një pikë të veçantë në dispozitivin e vendimit të ngritjes në detyrë apo atij të përfundimit të skemës së delegimit për ndërprerjen e gjykimeve, praktikisht në arsyetimin e vendimit dhe në relacionin pjesë përbërëse të vendimit (në kushtet kur unë e kam kërkuar por nuk më rezulton një vendim i zbardhur në fakt, për ngritjen në detyrë të gjyqtarës {...}), është cituar që gjyqtarja duhet të dorëzojë detyrën dhe afati lihet me qëllim që të dorëzojë detyrën.

Ç'ka ndodhur pas këtij momenti?

Mbas këtij momenti ne kemi marrë vendimin për përfundimin e shërbimit në skemë delegimi dhe i kemi dhënë afat në datën 01.02.2022. Sigurisht është e drejtë ajo që thotë zoti Kurushi që ne në këtë vendim nuk kemi shprehur se çfarë do të ndodhte me çështjet që kishte në shqyrtim sepse ne e kishim diskutuar një herë këtë çështje kur kishim diskutuar ngritjen në detyrë dhe për këtë shkak i kishim dhënë efekt të vonuar. Për këtë arsye, Këshilli nuk e ka të parashikuar ndërprerjen në pjesën e përfundimit në skemën e delegimit.

Mbas këtij momenti kemi dy situata të ndryshme në dy gjykata apeli ku gjyqtarja {...} ka shërbyer.

Çka bërë Gjykata e Apelit Durrës?

Gjykata e Apelit Durrës, mbi bazën e vendimit që ne kemi çuar dhe që siç duket ka qenë vendim jo i zbardhur por ka qenë vendim i shkurtuar, ka rishortuar të gjitha çështjet që gjyqtarja {...} ka pasur për shqyrtim, të nxjerra sipas kalendarit të gjykimit, qoftë si relatore, qoftë si anëtare, si dhe të gjitha çështjet e caktuara prej saj si relatore por të pahyra në kalendarin e gjykimit, të paplanifikuara ende. Këto çështje madje (disa prej tyre), sipas shkresës së kryetarit të gjykatës, kanë përfunduar edhe gjykimit. Kanë mbetur edhe katër çështje të cilat janë rindarë për relator, ku plotësimi i trupit gjykues është i pamundur sepse ka papajtueshmëri të gjyqtarëve të tjerë. Në fakt, kryetari i gjykatës së Durrës, nga ajo që unë kuptoj, nuk ngre shqetësim, por kërkon delegim gjyqtari.

E njëjta gjë është kuptuar edhe nga Gjykata e Apelit Administrativ, ku është kërkuar delegim gjyqtari nga kryetarja e gjykatës. Pra nuk është ngritur ndonjë problematikë.

Gjyqtarja në fakt ka pasur çështje edhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë. Nuk kemi informacion se çfarë është bërë por ka gjasa që nëse ato kanë përfunduar, duhet të jenë caktuar midis gjyqtarëve të tjerë sepse tek ne nuk është bërë ndonjë kërkesë për delegim gjyqtari (të paktën me sa jam unë në dijeni).

Ndryshe ndodh në Gjykatën e Apelit Shkodër. Gjykata e Apelit Shkodër, edhe pse ka pasur vetë si gjykatë një praktikë të konsoliduar në rastin e gjyqtarit {...}, shpreh shqetësimin se çfarë do të bëjë me çështjet ku zonja {...} ka qenë e caktuar për të gjykuar si gjyqtare e skemës së delegimit.

Marrin rastin e zotit {...}. Zoti {...} ka qenë edhe zi gjyqtar i skemës së delegimit. Këshilli e ka ngritur në detyrë tashmë në një juridiksion të posaçëm (Gjykata e Posaçme e

Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar) dhe nuk i ka caktuar as afat për të përfunduar gjykimin e çështjeve, por njëkohësisht ka përfunduar edhe shërbimin në skemën e delegimit sepse në atë kohë është konsideruar që gjyqtari duhet të ushtronte detyrën në gjykatën e shkallës së parë sepse dëmtohej në një shkallë më të madhe funksionaliteti nëse do t'i lihej një afat në Gjykatën e Apelit Shkodër.

Ç'ka ndodhur në Gjykatën e Apelit Shkodër?

Kur gjyqtari {...} ka ardhur në shkallë të parë, çështjet që ka pasur si gjyqtar i skemës së delegimit janë shortuar dhe nuk kemi pasur këtë problematikë.

Edhe në rastin e zotit {...}, e njëjta gjë ka ndodhur. Pra çështjet që ai ka lënë në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë janë rishortuar.

Në vlerësimin tim, duke marrë parasysh një situatë të ndryshme në fakt që tashmë ka ndodhur, për të mos interferuar dhe cenuar vijueshmërinë e gjykimeve në Gjykatën e Apelit Durrës, tashmë të përfunduara dhe që kanë përfunduar nga trupa të tjerë gjykues ku gjyqtarja {...} ka qenë prezent, duke marrë parasysh qëllimin e vendimmarrjes së Këshillit që në datën 01.02.2022 ajo duhet të dorëzonte detyrën, çka nënkuptonte ndërprerjen e gjykimet të çështjeve të tjera, vijimi i gjykimet të çështjeve, nuk mund të lejohet dhe nuk mund të bëhet. Edhe për një shkak tjetër, sepse pavarësisht se jemi në një juridiksion apeli, ngritja në detyrë e gjyqtarit në Gjykatën e Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit, për efekt të karrierës së gjyqtarit, është një gjykatë më e lartë dhe në këtë gjykatë gjyqtari duhet të jetë në detyrë në mënyrë të vazhdueshme dhe nuk mund të shkëputet qoftë edhe për afatet e gjykimet, që ai të shkojë të gjykojë në gjykata të tjera. Deri më sot, anëtarët e kësaj gjykate, që në momentin që është krijuar si gjykatë e posaçme, sikundër edhe për apelin administrativ, asnjëherë nga Këshilli nuk janë caktuar për të gjykuar në gjykata të tjera.

Unë vlerësoj që për shkak të kësaj situatë dhe për të qartësuar në fakt edhe qëllimin e vendimmarrjes së Këshillit në momentin kur ai ka lënë afatin dhe kur është shprehur që ajo duhet të dorëzonte detyrën, ndoshta do të ishte e udhës dhe unë e propozoj që të bëhet një shtesë, pra jo me vendim më vetë, por të bëhet një shtesë në vendimin nr. 44, të datës 31.01.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit për gjyqtaren {...}”, duke saktësuar se, pas pikës 2 e cila përcakton se efektet e vendimit fillojnë në datën 01.02.2022, duhet të shtohen dy pika me këtë përmbajtje:

“2.1 Rindarjen me short të të gjitha çështjeve në shqyrtim nga gjyqtarja {...} si dhe atyre të caktuara për shqyrtim si relatores deri në datën 01.02.2022.

2.2 Vijimin e procedurave për plotësimin e trupit gjykues ku gjyqtarja {...} ka qenë anëtare në datën 01.02.2022.”

Nëpërmjet këtij saktësimi që ne do t'i bëjmë vendimit (nëse mbledhja e pranon) për përfundimin e afatit në skemën e delegimit, qartësohet/ligjërohet edhe situata që ka ndodhur në Gjykatën e Apelit Vlorë (*Shkodër*), referuar edhe praktikës që është ndjekur deri tani në gjykatat e tjera.

Në vijim, nëse kalon propozimi që unë kam për mbledhje plenare, duhet të procedohet me delegim gjyqtari për sa i përket Gjykatës së Apelit Durrës dhe Gjykatës së Apelit Administrativ dhe duhet të njoftohet edhe gjykata e Apelit Shkodër për vijimin e procedurave të delegimit dhe për të saktësuar sepse kryetari ndoshta në atë shkresën që ngre shqetësim shprehet që ose do të vazhdojnë të shqyrtohen nga kjo gjyqtare apo duhet të caktohen gjyqtarë të tjerë, pra edhe ai nuk e ka të qartë situatën.

Për ta përmbledhur me një fjali, unë jam dakord me konkluzionin e dytë të paraqitur si propozim nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për ndërprerjen e gjykimit të të gjitha çështjeve, por për efekt të formulimit, për efekt të vendimmarrjeve të Këshillit, dhe për efekt të teknikës legislative që duhet përdorur, mendoj që ky konkluzion duhet të vijë në formatin e një shtimi në vendimin nr. 44, datë 31.01.2022, ku pas pikës 2 të shtohen pikat: “2.1 Rindarjen me short të të gjitha çështjeve në shqyrtim nga gjyqtarja {...} si dhe atyre të caktuara për shqyrtim si relatores deri në datën 01.02.2022.

2.2 Vijimin e procedurave për plotësimin e trupave gjykues ku gjyqtarja {...} ka qenë anëtare në datën 01.02.2022”. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, Brikena!

Nga kolegët kemi më diskutim?

Brikena, ti je me qëndrimin e dytë, por me një formulim tjetër?

Brikena Ukperaj: Me një formulim tjetër dhe në kuadrin e një shtese në vendimin nr. 44, datë 31.01.2022.

Klodian Kurushi: Më falni, të ndërhyj, të bëj edhe unë një koment të vogël mbi atë çfarë u diskutua deri tani. E ndjej të nevojshme të komentoj diçka për këtë pjesën që u parashtrua nga kolegja jonë.

Kjo situatë nuk është e rregulluar në ligj dhe as me akte nënligjore, pra situata se çfarë bëhet me gjyqtarin që në skemë delegimi promovohet, ngrihet në detyrë dhe caktohet në një gjykatë tjetër. Çfarë bëhet me çështjet që ai ka pasur në gjykim? Kjo situatë nuk është e rregulluar në ligj. Ama ne kemi pasur praktika, praktika të nxjerra nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Jo pa qëllim, në bërjen e relacionit dhe dhënien e propozimeve tona, ne kemi mbajtur parasysh edhe këto praktika. Është e vërtetë ajo që çfarë tha kolegja që për zotërinjtë {...} dhe {...} që kanë qenë gjyqtarë të gjykatës së shkallës së parë (në Gjykatën e Tiranës dhe në Gjykatën e Tropojës, i ardhur në apel dhe më pas kthyer në shkallë të parë në gjykatën e posaçme), është vepruar ashtu sikurse u parashtrua edhe nga kolegja. Por ne i jemi referuar edhe një praktike tjetër, që ne menduam që është shumë e ngjashme me rastin konkret (të znj. {...}) dhe praktika konkrete i referohet gjyqtarës {...}. Kjo gjyqtare ka qenë gjyqtare e gjykatës së shkallës së parë në skemë delegimi, ashtu sikurse edhe gjyqtarja {...}. Ka vijuar funksionin e saj si gjyqtare e Gjykatës së Apelit Korçë, por për nevojat e gjykimit, dhe këtu po e theksoj, për nevojat e gjykimit është caktuar specifikisht nga KLGJ-ja, me vendime konkrete në rastet kur gjykatat e apelit, të ndryshme nga ajo e Korçës, kanë paraqitur nevojën për të marrë një gjyqtar me qëllim plotësimin e trupit gjykues. Edhe në këtë rast është hedhur shorti nga KLGJ-ja. Unë i mëshoj shumë kësaj pjesës së parë, pjesës së hedhjes së shortit, pjesës së fillimit të marrjes së detyrës nga gjyqtari dhe shqyrtimit të çështjes nga gjyqtari. Pse? Sepse janë elementët e një procesi të rregullt ligjor dhe kjo është arsyeja që ne e kemi shprehur edhe në relacionin tonë parimin e “gjyqtarit neutral”.

Po si do ta heqim këtë gjyqtar nga ushtrimi i detyrës ne?

Po ja që është e vërtetë që e kemi emëruar gjyqtar në Gjykatën e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

A ka ndonjë dispozitë ligjore për Gjykatën e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të mos gjykojë, në rastet kur e kërkon nevoja, të caktohet në gjykata të tjera për të gjykuar çështje kur paraqitet nevoja për të gjykuar çështje të tjera nga gjykatat e apelit të juridiksionit të zakonshëm? Unë nuk gjej ndonjë dispozitë penguese. E mirëkuptoj shqetësimin dhe atëherë edhe unë bashkohem me shqetësimin që normalisht gjyqtarët e profilizuar për gjykime të veçanta/specifike nuk do të ishte e mirë dhe e drejtë

që t'i caktonim në gjykime të zakonshme penale, por pengesë nuk ka. Vetëm po të kishim një pengesë ligjore, atëherë do të diskutonim ndryshe. Për sa kohë nuk ka pengesa ligjore, atëherë ne po parashtrijmë në këtë diskutim parimet mbi të cilat duhet të mbështesim edhe argumentet tona. A është i pamjaftueshëm parimi i “gjyqtarit neutral”? - sepse ajo i ka nisur çështjet.

Mund të ndërhyjmë ne brenda procesit të rregullt ligjor? Ne mund të ndërhyjmë. Është një propozim që të ne mund të ndërhyjmë dhe të marrim gjyqtarë të tjerë.

Po pse mund të ndërhyjmë? Ne mund të ndërhyjmë ligjërisht vetëm në rastet kur gjyqtari, pas emërimit nuk do plotësonte kushtet konkrete për të qenë gjyqtar në gjykimin e çështjeve që ai faktikisht i ka nisur. Pra nëse gjyqtarja {...} do kthehej në shkallë të parë, do dakordësoheshin besoj të gjithë, që ajo nuk plotëson kushtet dhe kriteret për të vijuar gjykimin në Gjykatën e Apelit Shkodër, në Gjykatën Administrative të Apelit apo në Gjykatën e Apelit Durrës. Por {...} është emëruar gjyqtare e Gjykatës së Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe i plotëson të gjitha kushtet për të gjykuar çështjet në rang apelesh kur e kërkon nevoja e kohës, e sistemit nevoja e çështjeve për të gjykuar. Në këtë pikë ne menduam që më e drejtë ndër këto zgjidhje, kur situata nuk është e parashikuar specifikisht në ligj, do të ishte zbatimi i parimit të “gjyqtarit neutral”. Nesër mund të hapen probleme nga Gjykata e Lartë dhe do thotë: Po si ka ndërhyrë dy herë KLGJ-ja për të kompozuar përbërjen e trupit gjykues, për të ndryshuar përbërjen e trupit gjykues? Na lejohet ta bëjmë ne një gjë të tillë? -Unë them jo! Ne shkojmë deri tek parimi i administrimit të pushtetit gjyqësor, por nuk ndërhyjmë dot në çështjen konkrete, për të hequr dhe për të emëruar gjyqtarë, për të caktuar gjyqtarë, përveç rasteve specifike kur e kërkon ligji.

Në vijim të këtij diskutimi, që edhe unë dua ta mbyll, po të shikoni edhe Rregulloren për skemën e delegimit, meqenëse mua si gjyqtar penalist më ndalohet ta përdor analogjinë për shkak të përvojës time profesionale, por analogjia lejohet në fushën e së drejtës administrative dhe civile, po të shikojmë vendimin e KLGJ-së nr. 22, datë 07.02.2019 “Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, në pikën 14 është miratuar nga ky Këshill që shërbimi në skemën e delegimit përfundon në afatin e caktuar në vendimin e Këshillit. Në këtë rast gjyqtari kthehet automatikisht në gjykatën ku ka pasur emërimin për nevoja të një vendimi të ri të Këshillit. Pra tregova skemën se kur përfundon dhe çfarë ndodh me

përfundimin e skemës së delegimit për gjyqtarin që do kthehet në detyrën e mëparshme dhe do vijojë gjykimin e çështjeve ku ai ka qenë më përpara.

Ndërkohë, në nenin 5, pika 5, të këtij vendimi, që i referohet rasteve të parimit të funksionit të skemës së delegimit, thuhet: Pas komandimit në skemën e delegimit, gjyqtari përjashtohet nga shorti në gjykatën nga e cila vjen, por përfundon gjykimin e çështjeve në shqyrtim. Pra në një fare mase, kjo lloj dispozite e vendosur këtu është reflektim i parimit të “gjyqtarit neutral”, pavarësisht se ne e çojmë në skemë delegimi, që mund të gjykojë edhe në apel gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, ama çështjet e filluara nuk i ndërpret, do t’i çojë deri në fund sepse është pasojë e parimit të “gjyqtarit neutral”. Pikërisht, mbështetur në këto jo vetëm dispozita por edhe praktikë e mirë që e konsiderojmë ne si Këshill, të vendosur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, ne rekomandojmë dhe propozuam rastin më të mirë të mundshëm, duke parë çështjen në këndvështrimin dhe në perspektivën e një procesi të rregullt ligjor ku mos të cenohet pavarësia dhe paanshmëria e gjyqtarit në raport me palët.

Nëse do të vijojmë më tej pastaj diskutimin në lidhje me propozimin e dytë, që po e marrim si të pranueshëm propozimin e dytë sepse edhe ai është i mbështetur në argumentet e parashtruara më lart, pasi këtu nuk ka asnjë gjë të ndarë, por keni menduar se ç’do të bëhet me çështjet gjyqësore nëse ne do t’i hyjmë edhe një herë ciklit të ri të delegimit të gjyqtarëve në gjykimin e çështjeve gjyqësore tashmë pa u përfunduar nga gjyqtarja {...}? Besoj se do hapen të tjera probleme dhe situata sociale të padëshiruara nga palët por edhe nga publiku për një gjykim të drejtë, i cili duhej të respektohej gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, të paktën për aq sa është e mundur. Gjyqtari i ri që do vijë mund të ketë probleme papajtueshmërie, palët mund të kenë probleme me gjyqtaren e emëruar, do hapim probleme të reja të cilat do ndikojnë edhe në cilësinë e gjykimin.

Kështu që, referuar në të gjitha këto argumente që thashë dhe të diskutuara së paku me kolegët e Komisionit, ne kemi konkluduar që zgjidhja më e mirë oportune dhe e përshtatshme është vijimi i gjykimin nga gjyqtarja {...} edhe në gjykatat e tjera, përveçse çështjet që ajo merr aktualisht në Gjykatën e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar sepse ajo gjyqtare plotëson kushtet për të qenë gjyqtare e gjykatës së apelit, nuk ka shkak papajtueshmëri, nuk ka ndonjë shkak tjetër që e bën të papajtueshme këtë gjyqtare me gjykimin e çështjeve të nisura praktikisht prej saj, njëkohësisht respektojmë edhe parimin e sigurisë juridike, pasi e kemi vendosur një herë me vendim dhe e lë që të

përfundojë çështjet deri në fund fare pa ndërhyrë në procesin e kompozimit të trupave gjykues. Faleminderit!

Brikena Ukperaj: Kryetare mund të shtoj diçka?

Alban Toro: Mundem edhe unë?

Naureda Llagami: Brikena, pastaj Albani!

Brikena Ukperaj: Shqetësimin që ka Klodi për çështjet e mbetura të pashqyrtuara nga gjyqtarja {...} e kam edhe unë, për ato çështje që gjyqtarja i ka pasur në gjykim dhe janë rishortuar tashmë dhe kanë përfunduar (janë një volum shumë më i madh çështjesh sesa 15 çështje). E dyta, çështjet në fakt janë më shumë civile sesa penale dhe nga ajo që shoh nga raportimet e gjykatave, nuk kanë pasur ndonjë ngutshmëri, sepse edhe ato penale kanë qenë me masa ekzekutimi të pazbatuara dhe ato penale të tjera me masë “arrest në shtëpi” (që ka qenë një), nuk ka filluar as shqyrtimi sepse seancat qenkan shtyrë për njoftimin e viktimës, pra nuk ka ndonjë ngutshmëri në llojin e çështjeve. Nga ana tjetër, këtë parimin e “gjyqtarit natyral”, Këshilli e ka marrë parasysh, ndoshta nuk e ka diskutuar, por ka një vendimmarrje të tij kur e ka ngritur në detyrë, pra është vullneti i Këshillit që zonja {...} edhe pse në mënyrë jo eksplicite, në datën 1 shkurt duhet të dorëzojë detyrën. Pra kjo është një gjë e vendosur nga Këshilli. Unë nuk e di nëse ndonjë anëtar tjetër ka pasur për qëllim që ky afat do t’i lihej vetëm për të përfunduar disa çështje dhe pastaj s’ka problem se mund të vazhdonte t’i gjykonte edhe çështjet e tjera. Afati 01.02.2022 është lënë për shumë arsye, edhe për efekt të dorëzimit të detyrës.

Duke qenë një çështje e ezauruar tashmë, nuk ka më diskutim për të thënë dhe për të vlerësuar se çfarë do të bëhet me çështjet e tjera. Diskutimi është vetëm për të saktësuar vendimin e përfundimit në detyrë në skemë delegimi.

Klodi referoi në disa praktika të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Nuk janë disa. Është një praktikë në fakt. Është praktika e zonjës {...}, e cila ka qenë gjyqtare në skemë delegimi në Gjykatën e Apelit Korçë dhe gjyqtarja është ngritur në detyrë në të njëjtën gjykatë. Këshilli nuk i ka lënë afat dhe nuk është shprehur që duhet të dorëzojë detyrën në Gjykatën e Apelit Korçë për faktin sepse ajo emërohej në atë gjykatë. Duke qenë se emërohej në atë gjykatë ajo vazhdonte të gjykonte çështjet dhe njëkohësisht mund të vazhdonte të gjykonte edhe çështjet e tjera që kanë qenë në gjykatat e juridiksionit të

përgjithshëm. Pra ky ka qenë i vetmi rast por ka ndryshim, si nga rasti i zonjës {...} ashtu edhe nga rasti i zotit {...} dhe i zotit {...}. Nuk janë raste identike. Ne sot e vlerësojmë situatën në fakt referuar disa rrethanave të funksionimit jo normal të sistemit. Por në një situatë normale, kur do të mbaronte shërbimi në një skemë delegimi dhe kur gjykatat do të kishin plotë gjyqtarë të tjerë, do ta diskutonim këtë gjë? Gjykimi në gjykatën e apelit nuk ka ritmin e gjykimit në gjykatën e shkallës së parë, janë gjykime që ndoshta mund të përfundojnë edhe për një seancë. Këtë e ka treguar Gjykata e Apelit Durrës që nga 56-60 çështje që gjyqtarja ka pasur në shqyrtim është bërë shumë shpejt ndryshimi i trupit gjykues, pra çështjet tashmë janë rihedhur në short dhe gjykimi për to ka përfunduar. Në vlerësimin tim, lënia e këtyre çështjeve, se ç'do të bëhet me këto çështje dhe a do të shkojnë gjyqtarë të tjerë, është diçka që nuk duhet të kondicionojë qëndrimin që duhet të mbajmë në lidhje me përfundimin e skemës së delegimit dhe vijueshmërinë e shqyrtimit të çështjeve në rastin e zonjës {...}.

Prandaj, duke respektuar edhe mendimin e Klodit, në fakt unë vazhdoj t'i qëndroj propozimit tim thjesht për të bërë një shtesë në vendimin e përfundimit në skemën e delegimit për të saktësuar dhe për të uniformizuar trajtimin e njëjtë të çështjeve gjyqësore, atyre që tashmë janë shpërndarë me short dhe janë gjykuar dhe atyre që tashmë presin për t'u gjykuar në Gjykatën e Apelit Shkodër. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Ukperaj!

Alban, për ty fjala.

Alban Toro: Faleminderit!

Nuk do kufizohet tek ato që tha Klodi, për të cilat konfirmoj që jam në të njëjtën frekuencë me të. Gjithsesi do të më duhet të theksojë faktin që KLGJ-ja si institucion publik është i detyruar të mbrojë mbi të gjitha interesin publik dhe sot është një fakt i pamohueshëm që sistemi i drejtësisë prej vitesh vuan nga sëmundja e zvarritjeve të proceseve gjyqësore. E drejta e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm është një ndër parimet më të rëndësishme të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut ku Shqipëria është anëtare, dhe kjo Konventë e detyron institucionin shtetëror publik që të sigurojë gjykatat të cilat ato administrojnë, të jenë në gjendje që qytetarëve t'u garantojnë të drejtën e disponimit të një vendimi brenda afatit të arsyeshëm. E thënë kjo në gjendjen aktuale, është një gjendje ku sistemi është në kolaps, ku vakancat e krijojnë

vazhdimisht këtë sistem dhe ku numri i çështjeve backlog janë jashtëzakonisht... pra afati i arsyeshëm në këtë skenar juridik, ku vlerësohen të drejtat e njeriut, është i frikshëm sepse afat të arsyeshëm nuk ka. Interesi publik këtu do të dëshironte ose do duhej t'i garantonte minimalisht palëve në proceset gjyqësore që të përfundojë pasiguria e tyre në aspektin e pozitës juridiko-civile të përfshira në ato procese ku janë. Kjo bëhet me detyrimin që gjyqtarët të cilët janë caktuar të mbarojnë ato çështje të cilat ato kanë në gjykim, për t'i dhënë fund kësaj pasigurisë.

Kështu që, duke vlerësuar një ekuilibër të drejtë midis interesit të gjyqtarit, për të hequr atë pjesën e gjykimeve të cilat ai po administron apo interesit të publikut për të mbaruar dhe për të marrë së paku një vendim në dorë (sepse për afat, e thamë që nuk bëhet fjalë të respektohet), atëherë në këtë rast, i vetmi fakt që dikton këtë kufizim për Këshillin e Lartë Gjyqësor është mbrojtja e interesit publik në këtë marrëdhënie dhe në këtë aspekt unë shikoj dhe jam për propozimin që gjyqtarja në fjalë duhet të mbarojë proceset gjyqësore që ka në dorë, kjo jo për luksin se duhet t'i mbarojë kjo gjyqtare apo edhe për faktin që është caktuar me short dhe është "gjyqtarja natyrale" e këtyre çështjeve, por kjo peshë detyrimisht do të bjeri mbi kolegët e saj, të cilët do të detyrohemi t'i marrim nga një gjykatë tjetër; mbi ato qytetarë të cilët akoma nuk kanë një vendim në dorë dhe që në fund të ditës interesi publik për të cilin ky institucion është krijuar për ta mbrojtur, fatkeqësisht nuk po e bën. Kështu që unë mbroj propozimin e Komisionit që gjyqtarja në fjalë t'i mbarojë të gjithë proceset që ka në dorë. Faleminderit!

Fatmira Luli: Mund të them edhe unë dy fjalë Kryetare?

Naureda Llagami: Po, Fatmira!

Fatmira Luli: Edhe unë jam dakord me propozimin e Klodit, për të qenë koherente edhe me atë mendim që shfaqëm me e-mail të tërë bashkërisht kur u shtrua për diskutim kjo çështje. Gjykoj që ne sot nuk mund të vendosim rregulla se është {...} apo dikush tjetër. Po duam të vendosim rregulla për mënyrën se si veprohet në rastet kur nga skema e delegimit caktohen me emërim në gjykata të tjera, t'i vendosim në një rast tjetër. Në këtë rast ne jemi të detyruar të shohim efikasitetin e gjyqimit, të shohim mos të zvarriten çështjet sepse me sa shoh informacionin, janë 14 seanca për një penale dhe kjo mund të çojë që të fillojnë edhe një herë nga e para këto seanca duke bërë një zvarritje shumë më të madhe, duke qenë se janë çështje që kanë afate dhe janë çështje penale. Në

këto kushte, unë jam me propozimin e Klodit dhe jo t'i bëhet shtesë, por t'i bëhet plotësim vendimit me propozimin që ka bërë Komisioni. Faleminderit!

Irena Plaku: Ta marrë edhe unë pak fjalën të lutem?

Naureda Llagami: Po, Irena!

Irena Plaku: Me të gjitha ato që u diskutuan, çështja për mua që është shumë problematike është fakti për ato çështje që janë hedhur në short, çështjet që ka pasur gjyqtarja pranë gjykatave të tjera të caktuara (apel Durrës dhe të tjera), të cilat në fakt duket sikur janë hedhur në short përveç Gjykatës së Apelit të Shkodrës. Në rast se ne marrim një vendim të tillë i bie që me këtë vendimin tonë të, me propozimin që është bërë, i bie që të gjitha ato çështje duhet të rihidhen, pra duhet t'i hiqen gjyqtarit të caktuar tashmë me short dhe t'i kalojnë përsëri {...} që është gjyqtarja për të cilën bëhet fjalë, çka do të sillte një anomali, sidomos për ato çështje që mund të kenë përfunduar (kush ka qenë gjyqtari i përcaktuar me ligj). Do të sillte edhe pavlefshmërinë e vendimeve. Kështu që unë nuk jam dakord për propozimin, që duhet të vazhdojë ato çështje, aq më tepër kur nuk kemi një informacion që janë hedhur në short apo jo njëherë. Se në qoftë se janë rihedhur në short, tashmë kemi një gjyqtar tjetër të caktuar. Kaq kisha për të thënë.

Klodian Kurushi: Më lejoni të bëj një ndërhyrje për ta sqaruar këtë situatën e ngritur si problem nga Irena. Ndoshta jam keqkuptuar unë në atë parashtrimet e mia dhe në atë relacionin që kemi parashikuar.

Statusi i çështjeve që ka pasur për gjykim gjyqtarja {...} është i ndarë në disa kategori: i) kemi çështje të cilat janë hedhur në short por nuk ka filluar ende shqyrtimi gjyqësor i tyre, për shkak të radhës së pritjes për t'u nisur gjykimi; ii) kemi çështje të tjera të cilat janë hedhur në short, dhe gjyqtarja {...} është gjyqtare (me cilësinë e relatores ose me cilësinë e anëtares së trupit gjykues); iii) kemi edhe disa çështje të tjera të cilat pas lënies së detyrës në Gjykatën e Apelit Durrës nga gjyqtarja {...}, çështjet nuk mund të hidheshin në short ndërmjet anëtarëve ekzistues në Gjykatën e Apelit Durrës sepse kishte shkaqe papajtueshmërie dhe çështjet kanë mbetur “pending” dhe kjo është arsyeja pse ka kërkuar kjo gjykatë caktim gjyqtari për çështje konkrete.

Në relacionin tonë kemi thënë që çështjet për të cilat nuk ka nisur procesi gjyqësor, nuk është çështje për t'u diskutuar sepse këto çështje janë çështje që do të marri

në administrim kancelari dhe kryetari përgjegjës i gjykatës për t'u hedhur në short. Ne diskutojmë vetëm çështjet që i referohen parimit të “gjyqtarit neutral”, pra atyre çështjeve gjyqësore ku gjyqtare {...} ka qenë prezent përpara palëve dhe ka kryer veprime procedurale (në cilësinë e relatores ose anëtares së trupit gjykues – ka marrë prova, ka refuzuar kërkesa për prova, ka shtyrë procesin gjyqësor, ka marrë vendim për njoftim palësh, etj., etj.). Pra jemi tek ky momenti ku ka filluar procesi gjyqësor dhe palët janë legjitimuar, kanë bërë kërkesa, në çështje penale mund të jetë deklaruar mungesa e të pandehurit, etj., etj., pra janë kryer veprime procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, ku palët kanë pasur akses dhe kanë marrë dijeni se gjyqtarja {...} është në përbërje të trupit gjykues në gjykimin e çështjeve në apel; pra kanë pasur mundësi të shprehin dakordësinë ose mosdakordësinë e tyre. Kjo është pjesa e parë e gjësë, dhe ndërmjet të tjerave, kjo është pjesa më e vështirë e diskutimit. Se pjesa më e thjeshtë pastaj është rasti kur ka edhe gjykime që janë në fazë të fundit të shqyrtimit gjyqësor, në konkluzionet përfundimtare. Por unë, së bashku me kolegët e mi, nuk ndajmë dot natyrën e çështjeve sepse e kemi problem, edhe një herë, nuk ndërhyjmë dot ne si KLGJ në përcaktimin e përbërjes së trupit gjykues dhe vlerësimin e fazës në të cilën ndodhet çështja gjyqësore. Pse e themi këtë? Sepse nuk na takon ta bëjmë. S’kemi dispozitë ligjore që të ndërhyjmë dhe të vlerësojmë që ndodhemi në fazën e përfundimit të çështjes; është çështje civile; është çështje administrative apo është çështje penale, që të marrim masa konkrete. Kam përshtypjen se përpara nesh çështjet janë njësoj, domethënë kanë një vlerë, një vlerë në detyrimin që kemi ne përpara gjykatës dhe palëve. Duhet të caktojmë një gjyqtar për gjykimin e çështjes konkrete për të cilën kërkohet ose jo mendim apo delegim apo nuk duhet ta caktojmë? Sepse duhet të vijojë procesi gjyqësor duke i dhënë vlerë vendimit që ne kemi marrë më përpara për caktimin e gjyqtarës {...}, kur është kërkuar, për të gjykuar çështje konkrete në Gjykatën e Apelit Shkodër dhe në Gjykatën e Apelit Administrativ. Kjo ishte çështja jonë.

Duke parë këto situata ne thamë që do ta vendosim propozimin tonë mbi disa elemente të rëndësishme që përbëjnë thelbin e procesit të rregullt ligjor. Preket gjyqtari pasi është caktuar me short nga kryetari apo nga KLGJ-ja, për t'u zhvendosur më pas në gjykimin e kësaj çështjeje, kur cilësitë e këtij gjyqtari nuk kanë ndryshuar në gjykimin e çështjes? Pra gjyqtarja {...}, pavarësisht se ka qenë në skemë delegimi, ka qenë gjyqtare e gjykatës së apelit, e ngarkuar me ligj dhe e njohur nga KLGJ-ja për ta caktuar {...}n si gjyqtare në gjykatë apeli. I ka ndryshuar këto cilësi sot me promovimin e saj si gjyqtare e

Gjykatës së Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar? Ne mendojmë se nuk i ka ndryshuar. Është gjyqtare e Gjykatës së Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, e cila ka për detyrë dhe për shkak të funksionit dhe cilësive që ka, duhet të vijojë gjykimin e çështjeve që ka si në Gjykatën e Apelit Shkodër ashtu edhe në Gjykatën e Apelit Administrativ.

Më lejoni t'ju them se kur ka qenë në skemë delegimi në gjykatën e apelit, kjo gjyqtare ka gjykuar edhe në Gjykatën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar sepse e kemi futur ne duke plotësuar kriteret si gjyqtare me cilësi specifike për të gjykuar çështje në Gjykatën e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe po ne e kemi caktuar në të njëjtën kohë edhe në Gjykatën e Apelit Shkodër edhe në Gjykatën Administrative të Apelit (me qendër në Tiranë).

E ndjeja shqetësim për t'ia u sqaruar. Për çështje të cilat nuk ka filluar gjykimin, do ndiqet rregull i përgjithshëm. Po e sqaroj edhe një herë, se ndoshta nuk e kemi pasqyruar mirë në relacionin tonë. Për ato çështje do të ndiqet rregull i përgjithshëm, pra çështjet do të hidhen në short. Ne e kemi fokusuar shqetësimin tonë vetëm tek çështjet ku gjyqtarja {...} është anëtare ose relatore e çështjeve konkrete në gjykatat e apelit Durrës, Shkodër dhe administrativ (me qendër në Tiranë). Çfarë do bëhet me këto, kur kjo gjyqtare ka marrë prova. Mund ta heqim këtë si gjyqtare nga trupi gjykues? Unë them vetëm në një rast po, do guxonim që ta bënim si veprim, nëse kjo gjyqtare nuk plotëson më, mbi bazën e emërimit që ne bëjmë, cilësitë për të qenë gjyqtare në gjykatën e apelit. Si shembull do të merrja nëse do ta promovonim në Gjykatë të Lartë. Nëse do ta promovonim {...} në Gjykatë të Lartë, automatikisht ajo nuk mund të gjykonte më në apel sepse nuk plotëson kushtet për të qenë gjyqtare në gjykatën e apelit. Por tani e ka vijuar gjykimin. E ndërpresim dot? Ndërhyjmë dot në kompozim, në përbërje të trupit gjykues ne si KLGJ? Unë druaj se mund të bëjmë ndonjë gabim nëse ndërhyjmë në këtë fazë ku ndodhen çështjet. Për çështjet e pafilluara dakordësohemi me të gjithë që do i nënshtrohen rregullit të përgjithshëm. Faleminderit!

Brikena Ukperaj: Kryetare, mund të saktësoj diçka?

Klodi ndau çështjet e pacaktuara ende për gjykim nga këto 11 apo 15 çështje që ne i kemi aktualisht problem. Por ndërkohë janë edhe 56 çështje të tjera që gjyqtarja ka qenë anëtare e trupit gjykues, ka marrë prova, ndoshta kanë qenë edhe në fazën e konkluzioneve përfundimtare në Gjykatën e Apelit Durrës dhe që kanë qenë çështje në

shqyrtim dhe këto çështje kanë përfunduar dhe janë rishpërndarë midis gjyqtarëve të tjerë dhe i kanë përfunduar një treshe tjetër e gjykatës së apelit (referuar përmbajtjes së shkresës së kryetarit të gjykatës). Këto 4 çështje, edhe këto i ka rindarë ai për relator. Janë rindarë çështjet. Çështjet e gjyqtares janë rindarë nga gjykata e apelit tashmë. Kërkohej plotësimi i trupit gjykues nga ana e kryetarit të Gjykatës së Apelit Durrës. Nga ana tjetër, diskutimi i Albanit për cenimin e funksionalitetit në fakt duhet të ishte ngritur Alban sepse ti ke qenë edhe relator i projektvendimit për ngritjen në detyrë të gjyqtares {...} dhe po nga ky Komision është përgatitur një relacion ku është thënë që do t'i japim efekt të mëvonshëm vendimit me qëllim që t'i lihet një periudhë e mjaftueshme të dorëzohet detyrën në Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Shkodër. Po pse do t'ia jepnim këtë afat ne gjyqtares kur ajo duhet të përfundonte gjykimin e të gjitha çështjeve që ka në shqyrtim? Pra unë mendoj që ky diskutim është tashmë i kaluar me vendimmarrjet e Këshillit, prandaj edhe propozova që thjesht duhet të bëhet një shtesë në vendim, ku të saktësojmë që të gjitha çështjet që ka pasur në shqyrtim gjyqtarja do të rindahen me short midis gjyqtarëve të tjerë dhe të vijojnë edhe procedurat për plotësimin e trupave gjykues.

Këshilli sot është duke trajtuar shumë kërkesa për delegim gjyqtari dhe koncepti i “gjyqtarit natyral” tashmë nuk e di sepse trupat gjykues për shkak të papajtueshmërive të gjyqtarëve, për shkak të largimit të gjyqtarëve, kanë ndryshuar ndoshta mbi 5 herë, edhe mbi 6 herë. Për këtë arsye vazhdoj t'i qëndroj propozimit.

Naureda Llagami: Atëherë, kemi dy propozime.

Si praktikë, hedhim një herë propozimin e ardhur nga një anëtar dhe më pas propozimin e Komisionit. Do propozoja që të hidhnim në votim propozimin e ardhur të zonjës Ukperaj, e cila e ka sjellë si një propozim të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit për gjyqtaren {...}”. Jeni dakord me propozimin e zonjës Ukperaj?

Më pas diskutojmë zbardhjen. Nëse ky propozim kalohet nga Këshilli, kalojmë më pas në detajimin e zbardhjes së tij.

Hedhim në votim propozimin e zonjës Ukperaj.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Kundër.

Naureda Llagami: Marçela!

Atëherë, Marçela votoi me shkrim nga sistemi që është kundër, se është në pamundësi ndoshta.

Marçela Shehu: Dëgjohem tani?

Kundër, votova edhe me shkrim, por nuk kisha internet.

Naureda Llagami: Po e pashë! Sa e lexova!

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Kundër.

Naureda Llagami: Pro.

Duke qenë se propozimi i Brikenës bën shumicën, mundet ta artikulojmë tashmë si është propozimi?

Brikena Ukperaj: Atëherë, projektvendimi titullohet “Për disa shtesa në vendimin nr. 44, datë 31.01.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit për gjyqtaren {...}””.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 45, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në shkronjën “d”, të pikës 3, të nenit 25, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vendimin nr. 22, datë 07.02.2019 “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, si dhe në vendimin nr. 593, datë 23.12.2021 “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të znj. {...}”, vendosi:

1. Pas pikës 2 të vendimit nr. 44, datë 31.01.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit për gjyqtaren {...}”, shtohen pikat 2.1 dhe 2.2 me këtë përmbajtje:

“2.1 Rindarjen me short të të gjitha çështjeve në shqyrtim nga gjyqtarja {...} si dhe atyre të caktuara për shqyrtim si relatores deri në datën 01.02.2022.

2.2 Vijimin e procedurave për plotësimin e trupave gjykues ku gjyqtarja {...} ka qenë anëtare në datën 01.02.2022.”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Faleminderit Brikena për leximin e projekt-aktit.

* * *

(Pika 13 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.03.2022)

Pika 14 shtesë e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).⁹

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:45 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

⁹ Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Ilir Rusi*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe marrëdhënieve me jashtë.

3. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.

4. Lorena Gerveri, Drejtore e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.

5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.

6. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.

7. Rezarta Taushani, Këshilltare pranë Njësisë Mbështetëse të Komisioneve.

8. Rudina Palloj, Këshilltare pranë Njësisë Mbështetëse të Komisioneve.

9. Staf administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

14 shtesë. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Çështja e fundit e cila u shtua në rendin e ditës për shkak të urgjencës lidhet me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme. Fjala i jepet relatorit të çështjes, z. Klodian Kurushi i cili relaton shkurtimisht relacionin “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Shkodër”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet se Gjykata e Apelit Korçë ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore (një në lëndë penale me karakter “tepër urgjent”).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Korçë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të

veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet me short gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Gjirokastër, përfshirë edhe gjyqtarin e skemës së delegimit të caktuar pranë kësaj gjykate.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Lidhur me përjashtimet nga shorti, Komisioni propozon që:

Në shortimin e çështjes, të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Gjirokastër, konkretisht: z.Dritan Banushi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Sokol Pina.

Me kaq mbyllet procedura e shortit dhe në tërësi e gjithë mbledhja plenare.

*Anëtarët ftohen të zbresin në hollin e institucionit për të marrë pjesë në ceremoninë e betimit, të gjyqtarës e cila u zgjodh për vendin vakant në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor në shortin e datës 08.03.2022.

* * *

(Pika 14 shitesë e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

***PROCESVERVBAL MBI CEREMONINË E BETIMIT TË ANËTARIT TË RI TË
KOLEGJIT ZGJEDHOR GJYQËSOR,***

I PËRZGJEDHUR NGA SHORTI I DATËS 08.03.2022¹⁰

(Mbajtur, më 09.03.2022)

Ceremonia e betimit u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 15:00 dhe mbaroi në orën 15:10.

Merrnin pjesë në ceremoninë e betimit:

- 1. Anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***
- 2. Përfaqësues nga stafi i administratës së KLGJ-së.***
- 3. Të ftuar të tjerë.***

Në datën 8 mars 2022, në hollin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, u hodh përmes një procesi publik transparent dhe gjithëpërfshirës shortin për përzgjedhjen e anëtarit për plotësimin vendit vakant në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor.

Ftohet znj. {...}, si anëtarja më e re e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, zgjedhur përmes shortit të datës 8 mars 2022, miratuar me vendimin nr. 89, datë 09.03.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të bëjë betimin sipas nenit 146, pika 4, të ligjit 10019, datë 28.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 101/2020.

Përmbajtja e betimit është: “Beto hem solemnisht se do të respektoj, do të mbroj dhe do t’i bindem Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Shqipërisë, se do të respektoj të drejtat dhe liritë e qytetarëve dhe do të përmbush detyrat e mia. Beto hem se do të kryej detyrën time me të gjitha mundësitë e mia dhe në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe pa favorizuar ndonjë person, parti politike apo subjekt zgjedhor”.

¹⁰ Përmbledhje.

* * *

(Ceremonia e betimit deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor